

Plani i qeverisjes së bujqësisë urbane pjesëmarrëse për luftimin e përjashtimit social në Rajonin e Danubit



Projekti bashkëfinancohet nga fondet e Bashkimit Evropian (ERDF, IPA, ENI)

AgriGo4Cities



Plani i qeverisjes së bujqësisë urbane pjesëmarrëse për luftimin e përjashtimit social në Rajonin e Danubit

Publikimi i projektit AgriGo4Cities

(Bujqësia urbane për ndryshimin e qyteteve: modele të qeverisjes për kapacitete më të mira institucionale dhe përfshirje sociale)

Menaxher i projektit: Jani Kozina

Partner kryesorë: Qendra Kërkimore Sllovene e Akademisë së Shkencave dhe Arteve

Redaktorët: Máté Szalók, Csaba Bende, Jani Kozina

Autorët: Mateja Šmid Hribar, Saša Poljak Istenič, Drago Kladnik, Jani Kozina, Peter Kumer, Jernej Tiran (ZRC SAZU); Barbora Kvačková (Pragë 9); Nela Halilović (MoV); Csaba Bende, Máté Szalók (CTRIA); Stefan Dudau, Bogdan Ciubotaru, Cristina Dumbravă (PMV); Lucia Vačoková (ENVICORP Sllovaki); Kaja Cunk (PiNA); Simana Markovska (ASWM); Florian Lintzmeyer, Christina Miller, Claudia Schwarz (ifuplan)

Ju lutem, citoni si: Szalók M., Bende Cs., Kozina J. (eds); Plani i qeverisjes së bujqësisë urbane pjesëmarrëse për luftimin e përjashtimit social në Rajonin e Danubit(2019). Székesfehérvár: Agjencia Qëndrore Rajonale Transdanubiane e Inovacionit

ISBN 978-615-00-4351-7

Botues: Agjencia Qëndrore Rajonale Transdanubiane e Inovacionit

Ilustrimi dhe shtypja: Alba Nyomda Kft.

Të gjitha fotografitë janë bërë nga partnerët e AgriGo4Cities.

Projekti bashkëfinancohet nga fondet e Bashkimit Evropian (ERDF, IPA, ENI).

A projekt a Duna Transznacionális Programból, az Európai Regionális Fejlesztési Alap támogatásával, az Európai Unió és a Magyar Állam társfinanszírozásával valósul meg.

Projekti bashkëfinancohet nga Agjencia Sllovene e Kërkimit të fondeve kryesore të Gjeografisë së Sllovenisë (P6-0101).

Përmbledhja ekzekutive	6
Hyrje	8
Nevojat dhe sfidat	8
Fokusi, qëllimet dhe aktivitetet.....	9
Bujqësia urbane pjesëmarrëse si një mjet për arritjen e efekteve më të gjera shoqërore.....	10
Konceptimi i bujqësisë urbane pjesëmarrëse	10
Mësimet e nxjerra nga praktikat e mira dhe vizitat studimore	13
Metodologjia e përbashkët e bujqësisë urbane pjesëmarrëse.....	21
Udhëzime për planin e veprimit.....	21
Trajnimi për planin e veprimit.....	26
Programi i tutorimit për planin e veprimit	28
Zbatimi i bujqësisë urbane pjesëmarrëse në zonat pilot	32
Përvijimi i zonave pilot	32
Testimi i metodologjisë së përbashkët të bujqësisë urbane pjesëmarrëse	36
Pilot 1 – Kopsht komunitar Paletka në Pragë 9, Republika Çeke	38
Pilot 2 - Krijimi i kopshteve urbane në Velenje, Slloveni	40
Pilot 3 – Kopshti komunitar dhe edukativ për nxënësit më vështirësi në të mësuar dhe në sjellje në Székesfehévár, Hungari.....	42
Pilot 4 – Kopshtari për të gjithë në Komunën Vaslui, Rumani.....	44
Pilot 5 – Kopshti peri-urban për të moshuarit dhe fëmijët me nevoja të veçanta në Blagoevgrad, Bullgari	46
Përfundime	48
Referencat	51
Partneriteti.....	52



Máté Szalók

Pellgu i lumit Danub është pellgu më ndërkombëtar i lumenjve në botë. Rajoni i Danubit, i cili shtrihet në mbi 14 shtete, përfshin disa nga pjesët më të zhvilluara të Bashkimit Evropian, vendet që janë bashkuar BE-së në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, vendet në fazën e para-anëtarësimit dhe vendet që janë subjekt i Politikës Evropiane të Fqinjësisë. **Duke përfutur nga ky nivel i madh i diversitetit**, Programi Transnacional i Danubit ofron një mundësi të shkëlqyer për të mësuar nga njëri-tjetri, duke kontribuar kështu në prosperitetin e Rajonit. Të njëmbëdhjetë organizatat partnere në AgriGo4Cities synojnë të përfitojnë nga kjo mundësi. Për të adresuar nevojat komplekse dhe sfidat e Rajonit të Danubit **në fushën e planifikimit pjesëmarrës, në përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban**, partnerët përdorën bujqësinë urbane.

Ky publikim është rezultat i një procesi intensiv të të mësuarit që synon zhvillimin dhe testimin e **konceptit të bujqësisë urbane pjesëmarrëse**. Për një zbatim efektiv të projektit partneriteti u nda në dy grupe: partnerët strategjikë ishin kryesisht përgjegjës për shkëmbimin e njohurive, ndërsa partnerët territorialë ishin ato që zbatonin veprimet pilot. Gjatë zbatimit të projektit partnerët kryen disa ndërveprime ku u takuan dhe diskutuan me akterë të ndryshëm me qëllim që të fitonin njohuri të thella për bujqësinë urbane. Bashkëpjesëmarrësit e studiuat temën nga aspekte të ndryshme, **zhvilluan një metodologji të përbashkët për bujqësinë urbane pjesëmarrëse dhe e testuan atë në pesë vende**. Në këtë publikim autorët përmbledhin njohuritë dhe përvojën e partneritetit në mënyrë që të ofrojnë udhëzime për akterë nga rajoni i Danubit dhe përveç kësaj zbatimin e metodologjinë së projektit AgriGo4Cities.

Gjatë zhvillimit të kornizës konceptuale, bashkëpjesëmarrësit hulumtuan zonat pilot (Blagoevgrad - Bullgari, Pragë 9 – Republika Çeke, Székesfehérvár - Hungari, Vaslui – Rumani, Velenje - Slloveni) gjatë së cilës ata i shqyrtuan komunat në raport

me katër temat kryesore të projektit: bujqësia urbane, planifikimi pjesëmarrës, përfshirja sociale dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban. Nga hulumtimi u zbulua se **bujqësia urbane në fushat pilot nuk është një fenomen i kohëve të fundit**, por që nga viti 2000 mund të vërehet një valë e re në të cilën bashkëpunimi i më shumë akterëve ka më shumë rëndësi sesa në epokën e mëparshme. Kjo ofron një bazë të mirë për aplikimin e planifikimit pjesëmarrës i cili është ende në fazën fillestare në zonat pilot. Në rastin e pesë komunave të shqyrtuara përfshirja e grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara është shënjestruar nga masat mbështetëse, megjithatë bujqësia urbane dhe planifikimi pjesëmarrës kanë vetëm një rol të vogël në këto strategji. Së fundi, të gjitha komunat kanë të paktën një dokument ligjor që synon qëndrueshmërinë mjedisore, megjithatë roli i bujqësisë urbane përmendet drejtpërdrejt vetëm në dy raste. Nga shqyrtimi i fushave kryesore të logjikës së ndërhyrjes së projektit, u zbulua se edhe pse në të gjitha komunat këto fusha janë adresuar nga strategjitë lokale, **ndërlidhja mes bujqësisë urbane, planifikimit pjesëmarrës, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban ende nuk është njohur plotësisht**.

Për të zhvilluar konceptin e bujqësisë urbane pjesëmarrëse, bashkëanëtarët analizuan praktikën e mira ekzistuese dhe organizuan pesë vizita studimore në vendet operative bujqësore. Ky proces zbuloi se **qëllimi kryesor i bujqësisë urbane nuk është kopshtaria por ndërtimi i një komuniteti**. Sa i përket komunitetit dhe ndërveprimeve shoqërore, njerëzit e rrezikuar dhe ato të parrezikuar kanë nevojë të ngjajshme, megjithatë ata duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme. Banorët në përgjithësi janë të organizuar mirë, por grupet e rrezikuara për t'u organizuar kanë nevojë për udhëzime ose mbështetje nga një OJQ apo institucione të tjera. Mënyra më e mirë për të lehtësuar integrimin e grupeve të rrezikuara është kur ata të përzihen me njerëz të parrezikuar. Për të krijuar një zonë bujqësore urbane dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e saj është e rëndësishme të garantohet përdorimi afatgjatë i tokës dhe financimi për të, të njihen nevojat dhe aftësitë e grupeve të synuara dhe të fitohet mbështetja e komunës dhe e sektorit ekonomik lokal dhe civil.

Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit në zonat pilot, njohuritë e marra nga praktikën e mira dhe vizitat studimore, bashkëpjesëmarrësit zhvilluan metodologjinë e bujqësisë urbane pjesëmarrëse. Ajo përfshin gjashtë hapa kryesorë të përgatitjes së një plan veprimi:

Identifikimin, Ideimin, Prototipin, Monitorimin, Shkallëzimin dhe Ndryshimin Sistemik. Metodologjia siguron udhëzime përgjatë gjithë procesit të plan veprimit, nga analiza e nevojave dhe sfidave përmes planifikimit të praktikave bujqësore urbane deri në vlerësimin dhe kapitalizimin e rezultateve. Për zbatimin efektiv të pilotëve, bashkëantaret zhvilluan një mjet trajnimi dhe një program mësimor për partnerët territorialë. Gjatë vlerësimit të zbatimit të tyre, u vërtetua **që trajnimi i liderëve dhe pjesëmarrësve** para fillimit të zhvillimit të një plan veprimi është një faktor kyç në sukses, gjithashtu dhe udhëzimet përgjatë procesit.



Për të testuar metodologjinë e zhvilluar bashkëantaret zbatuan veprime pilot. Fillimisht, partnerët territorialë krijuan partneritete lokale të cilat kanë provuar të jenë shumë efektive gjatë planifikimit dhe zbatimit të planit të veprimit. Këto partneritete përfshinë aktorë publikë, përfaqësues të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara si dhe akterë të tjerë të interesuar. Gjatë pilotimit partnerët organizuan mbledhje pune me përfshirjen e akterëve dhe përfituesve përfundimtarë për të zhvilluar një plan veprimi. Gjatë procesit, partnerët fituan njohuri dhe përvojë mbi mënyrën se si të zbatojnë me sukses bujqësinë urbane pjesëmarrëse dhe identifikuan faktorët kryesorë të suksesit.

Partnerët, ndërkohë që punonin me grupet e rrezikuara, vërejtën se **fitimi dhe ruajtja e besimit kishin shumë rëndësi**. Për këtë, është i rëndësishëm komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet palëve, si dhe vërtetimi i aftësisë për të qenë i aftë për të realizuar idetë e grumbulluara. Për pjesëmarrje efektive **rregullat e procesit duhet të vendosen që në fillim**, megjithatë ato nuk duhet të jenë shumë të pandryshueshme, sepse mjedisi miqësor dhe joformal lehtëson angazhimin e akterëve. Udhëheqësi i procesit të plan veprimit duhet të ketë parasysh **kompleksitetin e planifikimit pjesëmarrës** në të cilin si pjesëmarrësit ashtu edhe synimet mund të ndryshojnë gjatë zbatimit.

Për këtë arsye udhëheqësit e procesit duhet të jenë të përgatitur për të reaguar shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj ndryshimeve.

Ky publikim detajon më shumë se dy vite të projektit Agrigo4Cities dhe siguron udhëzime për këdo që është i interesuar në përmirësimin e kapaciteteve institucionale, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban. Në kapitujt e mëposhtëm dokumenti sintetizon njohuritë dhe përvojën e fituar nga partnerët e projektit gjatë këtij procesi. Gjithashtu, përshkruhen edhe sfidat komplekse me të cilat janë ballafaquar partnerët e projektit gjatë zbatimit të qasjes pjesëmarrëse të bujqësisë urbane.

Nevojat dhe sfidat

Jani Kozina

Sfidat kryesore që lidhen me sistemet e qeverisjes brenda rajonit të Danubit lidhen **me zvogëlimin e kapaciteteve të autoriteteve publike për të përfshirë qasjen pjesëmarrëse në planifikim**. Masat e reja të kursimit i kanë lënë administratorët publikë me instrumente dhe kanale të kufizuara për përfshirjen e shoqërisë civile dhe aktorëve relevant në proceset vendimmarrëse. Mungesa e mekanizmave pjesëmarrës kontribuon në rënijen e motivimit të njerëzve për t'u angazhuar në qeverisje dhe administratë, sepse ata ndjehen të larguar nga agjendat politike, sociale dhe ekonomike dhe nuk janë mjaftueshëm kompetente për të vepruar si homologë ekuivalent dhe si nxitës të konsiderueshëm të ndryshimit. Boshllëku midis qytetarëve dhe autoriteteve publike po rritet në të gjitha nivelet dhe si pasojë sjell një mosbesim dhe mungesë të pjesëmarrjes së publikut, veçanërisht ndërmjet komuniteteve më të pafavorizuara në rrezik përjashtimi, siç janë komunitetet e varfra, të papunët, të pastrehët, komunitetet romë, emigrantët, të moshuarit, gratë dhe fëmijët.

Rritja e pabarazisë shoqërore dhe ekonomike reflektohet në një **jetesë të reduktuar dhe në cilësinë e vendit**.

Për të kapërcyer këto sfida, Projekti AgriGo4Cities ka përdorur **bujqësinë pjesëmarrëse urbane dhe peri-urbane** si një metodë të re dhe të fuqishme për të përmirësuar kapacitetet institucionale publike për trajtimin e përjashtimit social të grupeve të marginalizuara dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm urban në rajonin e Danubit. Projekti testoi metodologjinë inovative të bujqësisë pjesëmarrëse urbane dhe peri-urbane **në pesë komunat e rajonit të Danubit**: Qarku komunal Pragë 9 (Republika Çeke), Komuna Velenje (Sloveni), Komuna Székesfehérvár (Hungari), Komuna Blagoevgrad (Bullgari), Komuna Vaslui (Rumani).

Qëllimi i këtij plani transnacional është **të integrojë të gjitha njohuritë dhe përvojat** e mbledhura gjatë procesit të hartimit dhe testimit të metodologjisë së bujqësisë pjesëmarrëse urbane dhe peri-urbane. Ky dokument synon të ofrojë mësim konkret se si të rrisin shërbimet publike, të promovojnë qytetarinë aktive, të përforcojnë pjesëmarrjen e publikut dhe të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e qyteteve nëpërmjet bujqësisë urbane dhe është menduar për këdo që është i interesuar në fushat e bujqësisë urbane, planifikimit pjesëmarrës, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban.



Fokusi, qëllimet dhe aktivitetet

Jani Kozina

Qëllimi kryesor i projektit AgriGo4Cities ishte të përdor bujqësinë urbane pjesëmarrëse si një metodë për të përmirësuar kapacitetet institucionale publike për trajtimin e përjashtimit social të grupeve të marginalizuara dhe stimulimin e qyteteve të banueshme në rajonin e Danubit. Projekti adresoi rënien e kapaciteteve të administratorëve publikë për të integruar qasjen pjesëmarrëse në proceset vendimmarrëse. Modelet e reja të qeverisjes urbane lehtësuan qytetarinë aktive të komuniteteve të pafavorizuara në rrezik përjashtimi nga axhendat politike, sociale dhe ekonomike dhe me përfshirje të ulët në praktikën e të mësuarit. Qasja e përmirësuar e planifikimit dhe shërbimet më të mira publike nxitën zhvillimin e qëndrueshëm urban në rajonin e Danubit. Projekti përmban një plan pune të shëndoshë për të krijuar dhe zbatuar mjete, ndërveprimet transnacionale të të mësuarit, strategjitë dhe veprimet pilot në mënyrë që të arrihen tre objektivat specifike të projektit.

Bashkëpunëtorët e AgriGo4Cities duke promovuar projektin në Banská Bystrica



1) Integrimi i qasjes pjesëmarrëse në proceset e vendimmarrjes

Projekti, duke integruar qasjen pjesëmarrëse në proceset vendimmarrëse, ka përmirësuar kapacitetet institucionale publike. Modelet e reja të qeverisjes kontribuan në rritjen e shërbimeve publike për të promovuar qytetarinë aktive, zhvillimin e shoqërisë civile, përforcimin e pjesëmarrjes publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban.

2) Rritja e përfshirjes sociale të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara

Projekti shtoj përfshirjen e komuniteteve të ndryshme në rrezik përjashtimi në proceset vendimmarrëse. Modelet e zgjeruara të qeverisjes urbane kontribuan në rritjen e përfshirjes socio-ekonomike të grupeve të marginalizuara, e cila ka qenë një nga sfidat më të mëdha shoqërore në rajonin e Danubit. Grupet e identifikuara në rrezik përjashtimi, në pesë zona pilote, kanë qenë të moshuarit, fëmijët, të papunët, nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe në sjellje, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nënat e vetme së bashku me fëmijët.

3) Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm urban

Projekti promovon zhvillimin e qëndrueshëm urban përmes bujqësisë urbane. Modelet e reja të qeverisjes nxitën krijimin e vendeve të punës, gjenerimin e të ardhurave, ndërtimin e komunitetit dhe cilësinë mjedisore në qytete. Fokusi ishte në lagjet e pafavorizuara ku jetojnë dhe punojnë komunitetet në rrezik përjashtimi. Përfshirja e tyre aktive në bujqësinë urbane ka kontribuar në prodhimin dhe furnizimin e ushqimit, reduktimin e sasisë së karbonit, menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, jetesë të shëndetshme aktive dhe në mirëqenie.



BUJQËSIA URBANE PJESËMARRËSE SI NJË MJET PËR ARRITJEN E EFEKTEVE MË TË GJERA SHOQËRORE

Konceptimi i bujqësisë urbane pjesëmarrëse

Saša Poljak Istenič dhe Peter Kumer

Bujqësia urbane është praktika e kultivimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit në ose rreth zonave urbane. Ajo mund të përfshijë bujqësinë, kopshtarinë, blegtorinë, akuakulturën, pylltarinë dhe bletarinë urbane. Bujqësia është e integruar thellë në strukturën urbane, në jetën sociale dhe kulturore dhe në ekonominë e qytetit. Përveç se në zonat urbane, ajo zhvillohet edhe në zonat peri-urbane, edhe pse mund të ketë karakteristika të ndryshme.

Kopsht komunitar në një grupë ndërtimi në Lubjanë



Bujqësia urbane është bërë një mjet për të rritur qasjen **në ushqimin vendas**; nga ana tjetër, është përdorur gjithashtu nga grupet e avokatëve apo institucionet arsimore për **të rritur ndërgjegjësimin** për shumë aspekte të ushqimit që ne i kemi harruar, për shembull se si rritet ushqimi, cilat kultura janë lokale dhe në cilën sezon ata rriten. Ajo luan një rol të rëndësishëm **në rritjen e sigurisë së ushqimit urban**, duke asistuar në transportin për konsumatorët dhe importin ushqimor. Gjithashtu kontribuon **në zhvillimin ekonomik lokal**, në qëllimet sociale globale si **zbutja e varfërisë** dhe **përfshirja sociale** e grupeve të tjera të rrezikuara siç janë gratë, të moshuarit, emigrantët etj.

Ajo gjithashtu karakterizon gjelbërimin e qytetit dhe **politikat e qëndrueshme urbane** në përgjithësi, veçanërisht duke kontribuar shumë në qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, të krijuara në Axhendën e re të BE-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. **Mjetet dhe proceset pjesëmarrëse** që vlerësojnë multifunksionalitetin e përdorimit të tokës, diversitetin e akterëve dhe ndërveprimet hapësinore dhe kohore të njerëzve dhe vendit mund të rrisin në masë të madhe potencialin e bujqësisë urbane.

Gjatë sistematizimit të bujqësinë urbane, u bë dallimi ndërmjet nivelit të kopshtarisë dhe ati bujqësor. **Kopshtaria urbane** përfshin aktivitete bujqësore që japin një prodhim përgjithësisht të ulët të ushqimit dhe efekt të ulët ekonomik. Qëllime të tjera, si argëtimi, lehtësimi i stresit, socializimi etj, zakonisht janë më të rëndësishme për kopshtarët sesa rritja e ushqimit. **Bujqësia urbane** i referohet modeleve të biznesit të qëllimshëm të ofrimit të produkteve ose shërbimeve bujqësore lokale ose rajonale, të cilat përfitojnë nga afërsia me qytetin dhe tregun, nga mundësitë e transportit etj.

Sipas nivelit të kopshtarisë dhe të prodhimit, kopshtet ushqimore urbane mund të ndahen në: ato të bazuara në prodhimin individual (kopshte familjare dhe kopshte me akordim) dhe ato të bazuara në skema kolektive (kopshte edukative, kopshte terapeutike dhe kopshte komunitare). Përveç qëllimit për vetë-ekzistencë (zakonisht vetëm të pjesshme), ato gjithashtu ofrojnë një shans për argëtim dhe turizëm dhe mund të rrisin ndjeshëm jetën shoqërore urbane, sidomos të njerëzve të përjashtuar nga shoqëria.

Fermat, të cilat kanë përshtatur strategjitë e tyre të biznesit në një vend urban ose peri-urban, mund të ndahen në dy grupe kryesore. Disa ferma përqëndrohen në prodhimin e ushqimit ose produkteve të tjera bujqësore (fibra, kozmetikë) ndërsa të tjerët ofrojnë mundësi arsimore, terapeutike, sociale si dhe argëtim.

Kopshti Komunitar në Banská Bystrica



Tipologjia e bujqësisë urbane

(e përshtatur nga veprimi kosto Bujqësia Urbane në Evropë)

KOPSHTARIA (USHQIMI) URBANE		BUJQËSIA URBANE	
KOPSHTE ME NDARJE	Kopshte të ndara; parcela të marra me qera sipas një marrëveshjeje qeramarrje; shumë të formalizuara, shpesh të menaxhuara nga një organizatë / shoqatë	USHQIMI LOKAL+ FERMAT	Prodhonjë për tregjet vendore; marrëdhënie direkte me konsumatorët; gjithashtu prodhim jo ushqimor (kozmetikë, fibra)
KOPSHTE FAMILJARE	Prodhimi jo-komercial i ushqimit për një familje; nuk ka institucione apo organizata të përfshira	FERMA EKSPERIMENTALE	Testimi i teknologjive të reja bujqësore, metodave të prodhimit, varieteteve dhe tipeve ose modeleve të ndërveprimeve shoqërore dhe ekonomike me mjedisin e tyre urban
KOPSHTE EDUKATIVE	Mjete mësimore që adresojnë prodhimin, përpunimin dhe konsumin e ushqimit; rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe shpërndarjen e ideve	FERMA EDUKATIVE	Mjet pedagogjik; programe mësimore ose qëndrime afatshkurtra për shkollat
KOPSHTE KOMUNALE	Bazuar në iniciativat poshtë-lartë dhe kanë prirje kolektive; prodhimin e ushqimit dhe ofrimin e funksioneve sociale për komunitetin	FERMA PËR AKTIVITETE ARGËTUESE	Ofrimi i mundësive rekreative të lidhura me aktivitetet bujqësore
KOPSHTE SOCIALE	Trajtimin e problemeve sociale; promovimin e integritimit të njerëzve në rrezik përjashtimi	FERMA SOCIALE	Trajtimi i problemeve sociale; promovimi i rehabilitimit të njerëzve të pafavorizuar dhe integrimin e njerëzve në rrezik përjashtimi
KOPSHTE TERAPEUTIKE	Ndodhen në institucionet e kujdesit shëndetësor fizik dhe mendor; gjithashtu kopshte kontemplative dhe kopshte aktive të orientuara kah prodhimi	FERMA TERAPEUTIKE	Përdorimi i aktiviteteve të lidhura me bujqësinë për shëndetin fizik ose mendor dhe mirëqenien; gjithashtu terapi profesionale
KOPSHTE TË BANORËVE TË PALIGJSHËM	Prodhimi i ushqimit në tokë të braktisur; joformale, ekstra-ligjore, jo të regjistruara dhe nuk janë subjekt i politikave publike	FERMA PËR KUJDESIN NDAJ MJEDISIT	Vlera e lartë natyrore dhe mjedisore dhe kontributi në ruajtjen e biodiversitetit ose agro-diversitetit; pjesë e planit të parandalimit të përmbytjeve dhe zjarrit, infrastruktura e gjelbër, rrjetet, brezat e gjelbërta, Natura2000
		FERMA TË TRASHËGIMISË KULTURORE	Ruajtja e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme përmes ruajtjes së materialeve tradicionale, ndërtesave, varieteteve dhe teknikave të kultivimit.

Bujqësia urbane dhe peri-urbane si një mjet për planifikimin pjesëmarrës

Planifikimi pjesëmarrës nënkupton përpjekjen sistematike për të parashikuar të ardhmen e dëshiruar të komunitetit dhe planifikimin për atë të ardhme, dhe kjo realizohet nëpërmjet **përfshirjes aktive të komuniteteve** të prekura. Në një situatë ideale, stafi i organizatës që do të udhëheqë planifikimin pjesëmarrës, pjesëtarët e popullatës së synuar, zyrtarët e komunitetit, qytetarët e interesuar, si dhe agjencitë e përfshira, shkollat dhe institucionet e tjera ftohen në tryezë dhe inkurajohen të flasnin sipas njohurive, përvojave, aftësive ose vizioneve të tyre.

Pjesëmarrja e të gjithëve duhet të mirëpritet dhe të respektohet dhe procesi nuk duhet të dominohet nga ndonjë individ, grup ose nga një këndvështrim i vetëm. Planifikimi me pjesëmarrje synon **harmonizimin e pikëpamjeve të të gjithë pjesëmarrësve** si dhe parandalimin e konflikteve ndërmjet palëve kundërshtarë. Përveç kësaj, **grupet e marginalizuara** kanë mundësi të marrin pjesë në procesin e planifikimit, veçanërisht kur procesi përshatet me nevojat dhe aftësitë e tyre.

Kopshtaria urbane dhe periurbane si një mjet për përfshirjen sociale

Kopshtaria mund të trajtojë përjashtimin social nga të gjitha aspektet: nga prodhimi, konsumimi, ndërveprimi shoqëror dhe angazhimi politik. Projektet e kopshtarisë dhe bujqësisë mundësojnë **prodhimin** përmes aktiviteteve që kanë shumë nga atributet e punësimit me pagesë dhe që konsiderohen si "punë". Mbjellja, kultivimi dhe punët e tjera të kopshtarisë shihen si kuptimplota dhe 'produktive'.

Projekte të tilla u japin pjesëmarrësve qasje në një aktivitet argëtues, aktivitet në të cilin shpesh herë nuk bëjnë pjesë. Në disa raste, gjithashtu u ofrohet ushqim që kontribuon në cilësinë e jetës së tyre. Në këtë mënyrë u lejonet të marrin pjesë në procesin e **konsumit**.

Aktivitetet gjithashtu ofrojnë mundësi për shumë forma të **ndërveprimit shoqëror**. Idealisht ndërveprimet rezultojnë në krijimin e lidhjeve të përhershme shoqërore dhe formimin e një komuniteti.

Projekte të tilla gjithashtu mund t'iu mundësojnë pjesëmarrësve që të merren me menaxhimin e një kopshti apo një aktiviteti dhe në këtë mënyrë t'i përfshijë ato në një formë të veçantë të **angazhimit politik**. Metoda e bujqësisë pjesëmarrëse urbane ka kështu një potencial të madh për t'i lehtësuar qytetarinë aktive të marginalizuarve social, të cilët përgjithësisht janë më pak të angazhuar politikisht dhe që rrallë përfshihen në proceset e të mësuarit. Për më tepër, ajo gjithashtu mund të sigurojë një mënyrë për të ndërtuar kapacitete institucionale. Duke përdorur bujqësinë urbane si një metodë, autoritetet mund të mbështesin dhe nxisin angazhimin e qytetarëve, duke përfshirë të marginalizuarit, në çështjet urbane.

Kopshtaria urbane dhe periurbane si një mjet për zhvillimin e qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm zakonisht është konceptuar si term i mbështetur nga tre "shtylla", gjegjësisht nga ekonomia (zhvillimi ekonomik / rritja ekonomike), mjedisi (mbrojtja e mjedisit / ekuilibri i mjedisit) dhe shoqëria (barazia sociale / përfshirja sociale). Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton balancimin e të tre objektivave të planifikimit urban në mënyrë që të arrihet rritja ekonomike pa shpërndarje të padrejtë të resurseve dhe pa rrezikimin e ekosistemit.

Bujqësia urbane dhe periurbane kontribuon ndjeshëm në zhvillimin e qëndrueshëm urban, pasi sjell përfitime ekonomike, social-kulturore, mjedisore si dhe psikologjike. Mund të ofrojë mundësi punësimi, të rrisë vetë-ekzistencën e ushqimit, sigurinë dhe qasjen, të ndikojë pozitivisht në dietë, shëndet, aktivitet fizik dhe mirëqenie personale, të forcojë ndjenjën e vendit dhe të komunitetit, të vendosë lidhjen dhe identitetin kolektiv, të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë personale dhe të rrisë barazinë gjinore.

Bazamenti i një kopshti në Banská Bystrica



Mësimet e nxjerra nga praktikat e mira dhe vizitat studimore

Mateja Šmid Hribar, Saša Poljak Istenič, Christina Miller, Claudia Schwarz dhe Florian Lintzmeyer

Praktikat e mira

Një burim i rëndësishëm i njohurive mbi mënyrën e krijimit ose menaxhimit të bujqësisë urbane mund të jetë praktika e mira e kopshtarisë me pjesëmarrje. Qëllimi kryesor i mbledhjes së tyre ishte ofrimi i ideve dhe udhëzimeve për mënyrën e hartimit të praktikave të suksesshme. Kur kërkojnë për raste, të gjithë partnerët e projektit bëjnë hulumtime në internet. Ata kërkuan shembuj në vendin e tyre, në rajonin e Danubit dhe në nivel global, dhe zgjedhën rastet më të mira duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- përfshirjen e grupeve të rrezikuara,
- pjesëmarrjen si qasje,
- trajtimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Këto raste më pas janë diskutuar në mbledhjen e të gjithë partnerëve të projektit. Zgjedhja përfundimtare u bë me votim, duke pasur parasysh llojet dhe aspektet e ndryshme të kopshteve pjesëmarrëse. Rastet e përzgjedhura u analizuan më tej përmes vizitave në terren, analizave të thella dhe thirrjeve telefonike ose në Skype, ku pjesa më e madhe e informacionit u mblodh nga intervistat gjysmë të strukturuar me iniciatorët, pjesëmarrësit, vendimmarrësit dhe akterët e tjerë të interesuar.

Partnerët analizuan praktikat e zgjedhura duke u fokusuar në:

- **Informacionin bazë** (karakteristikat kryesore dhe grupet e përfshira)
- **Krijimin e kopshtit** (iniciativa, financimi, mbështetja, mënyrat e përfshirjes),
- **Rolet e akterëve të përfshirë** (llojet, detyrat, angazhimi),
- **Karakteristikat dhe specifikat e praktikës** (Pse është e nevojshme praktika?),
- **Aspektet pjesëmarrëse** (pjesëmarrja dhe përfshirja e grupeve të rrezikuara),
- **Planet e ardhshme** (trajektorët potenciale të zhvillimit),
- **Udhëzimet dhe mësimet e nxjerra** (këshilla dhe udhëzime për iniciatorë),
- **Imazhin personal** (motivet dhe vlerat e akterëve të përfshirë në praktikën e mirë).




U identifikuar 21 praktika të mira, 17 nga rajoni i Danubit dhe 4 nga jashtë (përfshirë një në Gjermani që nuk i përket zonës së programit të Danubit). Megjithëse për shkak të përvojave të kaluara të regjimit socialist praktikat e rajonit të Danubit janë **më të lehta për tu transferuar**, ata jashtë Rajonit të Danubit shërbejnë si një mjet **për të menduar ndryshe** kur i afrohem praktikës, veçanërisht për shkak se ata janë ndërtuar mbi traditën e gjatë të **ushtrimit të demokracisë**.


Kategorizimi i dytë u bazua në llojin e praktikës pjesëmarrëse sipas tipologjisë së Kostos, e cila i ndan ato në bujqësi urbane dhe kopshtari urbane. Praktikrat e identifikuar ishin të gjitha në shkallë të vogël, dhe i përkisnin kategorisë së kopshtarisë urbane. Kjo mund të jetë një tregues se praktikrat në shkallë të vogël janë më të lehta për t'u menaxhuar dhe zbatuar kur dëshirohet të përdoret një qasje pjesëmarrëse dhe kur përfshihen në mënyrë të barabartë grupet e rrezikuara.

Duke u bazuar në grupet e rrezikuara të përfshira, praktikrat e mira bujqësore urbane u kategorizuan më tej në këto lloje:

- **kopshte komunitare**, të cilat nuk janë drejtpërsëdrejti të fokusuara në përfshirjen e grupeve të rrezikuara, por në përgjithësi adresojnë qytetarët në një zonë të caktuar; individët e cënuar integrohen në komunitet;
- **kopshte sociale**, të cilat përqendrohen në përfshirjen e një grupi të caktuar vulnerabël (p.sh. emigrantët, romët, nxënësit e larguar nga shkolla etj);
- **kopshte edukative**, të cilat zakonisht janë të organizuara në shkollat fillore dhe të mesme; dhe
- **kopshte terapeutike**, të cilat përqendrohen tek personat me aftësi të kufizuara, personat me probleme mendore ose shëndetësore (personat e varur nga alkooli, të sëmurët mendorë etj).

Praktikat e mira të bujqësisë urbane pjesëmarrëse sipas vendndodhjes gjeografike





Analiza e praktikave të mira të bujqësisë urbane pjesëmarrëse zbuloi se:

- Grupet e rrezikuara të përfshira në praktikën e identifikuar janë **shumë të ndryshëm** (sidomos grupi i fëmijëve dhe të rinjve),
- Grupet e rrezikuara zakonisht nuk janë në gjendje për t'u organizuar dhe për t'u vetë aktivizuar, ata kanë nevojë për ndihmë, zakonisht nga një OJQ;
- Banorët e mirë organizuar janë të suksesshëm dhe proaktivë**, por ato nuk mund të klasifikohen si një grup i rrezikuar; megjithatë, ata zakonisht kanë nevoja të ngjashme, si një mundësi për të krijuar kontakte sociale dhe për t'u shoqëruar, për të zhvilluar **ndjenjën e përkatësisë**, si dhe për të prodhuar **ushqim të freskët dhe të shëndetshëm** sipas zgjedhjes së tyre;
- Rastet më të suksesshme janë ato me shumë akterë të ndryshëm që ndihmojnë njëri-tjetrin dhe ato kur **grupet e rrezikuara përzihen** me anëtarët e grupeve jo të rrezikuara;

- Në përgjithësi, **ndërtimi i një komuniteti** është më i rëndësishëm për pjesëmarrësit sesa kopshtaria, edhe pse përdoruesit me të vërtetë e pëlqejnë atë;
- Vendimmarrësit janë kryesisht të përfshirë në mënyrë indirekte**, ato ofrojnë infrastrukturë dhe marrin pjesë në ngjarje nëse janë të ftuar, por nuk angazhohen personalisht në praktikë; megjithatë, kjo forcon strategjinë nga poshtë-lartë;
- mungesa e fondeve** (minimale dhe të përhershme), si dhe **parcelat** e pasigurta kërcënuan praktikën e bujqësisë urbane,
- Kopshtet urbane kontribuojnë në qëndrueshmëri, sepse sjellin natyrën dhe biodiversitetin në qytete (ekologjinë), **aktivizojnë njerëzit** që kanë vështirësi në integrimin në shoqëri duke rritur dialogun mes brezave dhe atë ndërkulturor; duke shkëmbyer, krijuar dhe transferuar njohuritë (shoqërinë); dhe duke siguruar perime dhe fruta të freskëta, pra duke shërbyer si një korrigjues social për banorët e varfër (ekonominë).



Vizita studimore

Gjatë dy viteve të fundit, partnerëve iu dha mundësia **për të mësuar nga përvojat e ngjashme** jashtë vendit të tyre. Nëpërmjet 5 vizitave studimore, ata morën përvojë të shkallës së parë në 5 vende të ndryshme: Slloveni (Velenje), Sllovakia (Banská Bystrica), Gjermani (Mynih), Çeki (Pragë) dhe Bullgari (Blagoevgrad).

Vizitat studimore ofruan njohuri mbi iniciativat dhe praktikatat lokale si dhe shansin për të mbështetur dhe përdorur kornizën e trajnimit ndërkombëtar, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit të mjeteve të trajnimit. Ato mundësuan **shkëmbimin e njohurive** ndërmjet grupit të ekspertëve të AgriGo4Cities dhe rajoneve pilotë si dhe ofruan mundësinë për një debat konstruktiv.

Pas çdo vizite studimore u diskutuan çështjet relevante në nivel lokal, pengesat, praktikatat më të mira dhe mësimet. Në tabelat e mëposhtme jepet një pasqyrë e shkurtër e gjetjeve kryesore.

Kopsht komunitar Përtej zonës së ndërtimit në Lubjanë



Vizitë studimore: Velenje, Slloveni



Numri i vendeve të vizituara:	3
Llojet e bujqësisë urbane:	Kopshte me ndarje të përkohshme (1) dhe të përhershme (2)
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> • secila familje në Velenje • familjet e minatorëve në Velenje • të papunët dhe personat me të ardhura të ulëta
Mësimet e nxjerra:	komuna është e vetëdijshme për rëndësinë dhe përfitimet e bujqësisë urbane / kopshte janë lehtësisht të arritshme përmes transportit publik dhe me biçikletë / vullnet të fortë politik

Vizitë studimore: Banská Bystrica, Sllovaki



Numri i vendeve të vizituara:	3
Llojet e bujqësisë urbane:	Kopshte komunitare
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> • shoqëria civile • adoleshentët • fëmijët me çrregullime mendore
Mësimet e nxjerra:	lehtësisht të arritshme në qendër të qytetit / vende për takime / të kombinuara me projekte kulturore / fleksibël dhe të hapur për zhvillim të mëtejshëm / diversitet (jo vetëm bujqësia urbane) / marketingu i produkteve të kopshtit / ngjarjeve



Vizitë studimore: Mynih, Gjermani



Numri i vendeve të vizituara:	4
Llojet e bujqësisë urbane:	Kopshte me ndarje (joformale) (1) dhe kopshte komunitare (3)
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> • refugjatë të rinj të pashoqëruar (nga 16-21 vjeç) • shoqëria civile • banorë të komuniteteve multikulturore dhe multietnike • të moshuarit, emigrantët, fëmijët
Mësimet e nxjerra:	financim të qëndrueshëm / udhëheqës dhe edukatorë me përvojë / hapësira arsimore dhe mësimore / eksperimentimi / përdorimi i materialeve të riciklueshme / të disponueshëm për të gjithë / mbështetje publike / afër zonave të banimit

Vizitë studimore: Pragë, Republika Çeke



Numri i vendeve të vizituara:	2
Llojet e bujqësisë urbane:	kopshte komunitare, ngjarje në ambient të hapur
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> • Institucionet parashkollore dhe shkollat fillore • nënat me fëmijë të vegjël • të moshuarit
Mësimet e nxjerra:	distanca në këmbë nga një çerdhe / furnizime në vend (p.sh. ujë, strehim) / punëtori / kopshte ekologjike / shesh lojërash



Vizitë studimore: Blagoevgrad, Bullgari



Numri i vendeve të vizituara:	4
Llojet e bujqësisë urbane:	kopshte sociale, kopshte terapeutike
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none"> fëmijët me nevoja të veçanta të moshuarit komuniteti Romë të papunësuarit
Mësimet e nxjerra:	ndërmarrja sociale komunale si punëdhënëse e grupeve të cënuara/ përfshirja ekonomike dhe sociale / përmirësimi estetik i parqeve publike / shikueshmëria publike / barazia gjinore / të përdorshme gjatë tërë vitit (kopshiti dimëror) / aspekti terapeutik/ financime të garantuara / mjaftueshëm të vogël sa për tu menaxhuar / personalizimi i pemëve

Duke iu referuar përvojave nga vizitat studimore dhe veçanërisht veprimet pilot të tyre, partnerët territorialë ishin në gjendje të reflektojnë mbi hapat që kanë ndërmarrë. Për zbatimin e suksesshëm të bujqësisë urbane pjesëmarrëse rekomandohet t'i kushtohet vëmendje:

Grupit të synuar

- Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje moshës së grupit të synuar. Për të kuptuar se si t'i adresosh me sukses një grup është e nevojshme të mësohen nevojat dhe aftësitë e tij. Më me rëndësi është lidhja me grupin dhe **mbajtja e kontakteve të drejtpërdrejta personale** me njerëzit e përfshirë.

- Përqendrimi në pjesëmarrësit më aktivë ndihmon në **mobilizimin** e atyre që janë më të ngathët (kushtojini vëmendje atyre që kanë potencial për të udhëhequr dhe atyre që pjesëmarrësit e tjerë do ti ndjekin).

- Krijohet **hapësirë pune të përbashkët** për më shumë njerëz.
- Vizualizimi është një mjet efektiv për komunikimin me të gjitha grupmoshat.
- Punëtoritë duhet të jenë **interaktive** dhe jo të dominuara nga leksionet.

Qëndrueshmërisë

- Punësimi i një **udhëheqësi** për koordinimin e aktiviteteve, pavarësisht angazhimit vullnetar të njerëzve të përfshirë.

- Krijimi i lidhjeve me **këshilltarët e qytetit, me organizatat** relevante dhe bashkëpunimi me ta.


- Jepni rezultate sa më shpejt që të jetë e mundur për të **ulur skepticizmin**. Mosbesimi dhe keqkuptimet mund të trajtohen duke punuar së bashku, në këtë mënyrë rritet besimi i atyre që dyshojnë në sukses.

- Fitoni përkrahjen e **kompanive lokale** për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit dhe jepni merita (p.sh. paraqitni përkrahësit në një bord).

- Merrni parasysh rutinat e ndryshme të pjesëmarrësve kur vendosni orën apo ditët e takimit.
- Është e nevojshme një **shpjegim i qartë** i të gjitha hapave dhe mundësive për të parandaluar konfliktet dhe zhgënjimet.
- Mendoni për **kushtet atmosferike** kur ndërtoni një kopsht (p.sh. bazamenti i kopshtit duhet të jenë në gjendje të mbajë tokë të lagur etj).
- **Krijoni ngjarje** për të ruajtur interesimin në projekt të pjesëmarrësve, akterëve të tjerë dhe të publikut të gjerë.



Kopshti peri-urban në Blagoevgrad



METODOLOGJIA E PËRBASHKËT E BUJQËSISË PJESËMARRËSE URBANE

Udhëzime për plan veprimin

Kaja Cunk


Për adresimin e bujqësisë urbane si një risi sociale, është e nevojshme plani i veprimit, me qëllim të integritit të mekanizmave pjesëmarrës në proceset e vendimmarrjes, për të rritur përfshirjen sociale të segmenteve të pafavorizuara të shoqërisë dhe për të nxitur jetueshmërinë në qytete.

Ekziston një shkëputje e madhe ndërmjet atyre që drejtojnë dhe organizojnë bujqësinë urbane dhe atyre që e rregullojnë dhe menaxhojnë atë.

Pa asnjë mbështetje formale, bujqësia urbane ka qenë kryesisht një proces pjesëmarrës nga poshtë-lart, zakonisht iniciuar nga individë apo organizata joqeveritare dhe jo nga qeveritë dhe planifikuesit urban. Duke ofruar udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e veprimeve, është e mundur që të **përmirësohen kapacitetet e administratorëve publikë për të përfshirë akterët relevantë dhe shoqërinë civile në qeverisje si dhe pjesëmarrjen e publikut përmes bujqësisë urbane.**

Bujqësia pjesëmarrëse urbane e suksesshme është një risi shoqërore. Për ta hartuar atë si të tillë, duhet të ndiqen gjashtë hapa nga diagnoza e mirë e situatës, përmes një procesi krijues ideimi dhe prototipesh përsëritëse deri në monitorimin e vazhdueshëm. Pasi të arrijë sukses, bujqësia pjesëmarrëse urbane mund të shtrihet në vende të reja dhe të jetë në shënjestër në një nivel më të lartë; duke ndryshuar sistemin.

Spiralja e rrisë shoqërore



Frymëzuar nga: Fondacioni i Ri, Libri i Inovacionit Shoqëror
- www.youngfoundation.org

IDENTIFIKIMI

Identifikimi është themeli i të gjitha fazave të mëtejshme, pasi që të kuptuarit është çelësi. Ekziston një shumëllojshmëri e qasjeve për analiza dhe hulumtimi i tyre është i nevojshëm sepse çdo rast është unik dhe kërkon një grup të veçantë teknikash identifikuese.

Në rastin e bujqësisë urbane me pjesëmarrje, u propozuan tri fusha të identifikimit:

- **Rrethanat shoqërore të grupeve të synuara;**

Analiza shoqërore mund të jetë e përgjithshme (analiza statistikore, anketime) ose e detajuar (vëzhgimi i pjesëmarrësve, intervista). Teknikat për të kuptuar rrethanat shoqërore përfshijnë mbledhjen e fotove, rrjedhën e burimeve, foto të ekspeditave, turne dhe të tjera.

- **Marrëdhëniet ndërmjet akterëve në lagjet dhe komunitetet e tyre;**

Çdo projekt është pjesë e një rrjeti më të gjerë të aktiviteteve dhe shërbimeve, të drejtuara nga akterë të ndryshëm. Kjo krijon mjedisin institucional në të cilin akterët duhet të bashkëpunojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin, për të siguruar suksesin e veprimit tonë.

- **Dimensionet hapësinore të zonës që do të përdoret për bujqësinë urbane.**

Hapësira është pjesë përbërëse e çdo aktiviteti dhe duhet të hulumtohet dhe të analizohet si në nivel të qytetit ashtu edhe të lagjes.

PROTOTIPI

Asnjë plan nuk është i përsosur që nga fillimi. Në vend të planifikimit të formatit përfundimtar të një kopshti urban, më parë duhet të merren parasysh disa hapa më të vegjël dhe gradualë. Prototipi lejon mbledhjen e reagimeve nga përdoruesit gjatë procesit të planifikimit si dhe hartimin e bujqësisë urbane me pjesëmarrje.

Prototipi duhet:

- të kursej kohë, energji dhe të mbledh investime;
- të ofroj një mundësi për të pasur diçka në një shkallë më të madhe;
- të theksoj elementet që përndryshe nuk do vihehin re;
- të sjellë kënaqësi më të lartë të përdoruesit.

Prototipi duhet të dokumentohet dhe të moderohet siç duhet, me shënime se si dhe pse diçka është ndryshuar dhe duke përcaktuar disa hapa drejt një përfundimi.

IDEIMI

Ideimi është një proces përsëritës i rishikimit dhe rafinimit të konceptit. Ai është një urë në mes të problemeve dhe zgjidhjes së tyre, dhe duke u bazuar në analizën dhe rezultatet e fazës së identifikimit, të çon drejt prototipit.

Pasi të jenë krijuar idetë është e nevojshme të shikohen aspektet e mëposhtme:

- Aspekti emocional;
- Organizativ;
- Eksperimental;
- Ekonomik;
- Shoqëror;
- Kulturor;
- Hapësinor.

Kjo gjë favorizon shumëllojshmërinë e ideve dhe mundësisë pasi secili aspekt zbulon fusha të papritura të inovacionit dhe sjell perspektiva të reja. Është e rëndësishme ti shpërndani këto ide, njohuri dhe pritshmëri, në mënyrë që të merren vendime nga mundësi të ndryshme.

Procesi i Ideimit përfshin një analizë të asaj që mund të arrihet sipas kufizimeve të theksuara, si dhe përpjekjet për të gjetur zgjidhjet optimale të kufizimeve të tilla.

MONITORIMI

Monitorimi siguron zbatimin efektiv dhe arritjen e qëllimeve përfundimtare të një bujqësie urbane pjesëmarrëse. Gjatë monitorimit, ne mbledhim dhe analizojmë të dhënat për aktivitetet që janë në vazhdim në mënyrë që të marrim informacion të hollësishëm për punën që është bërë.

Edhe pse monitorimi zakonisht bëhet pas ose gjatë aktiviteteve të projektit, një hap vendimtar ndodh në fillim, që është përcaktimi i treguesve kryesorë të performancës. Më të rëndësishmit ndër këto janë:

- të dhënat (burimet e nevojshme);
- aktivitetet (puna aktuale që duhet bërë);
- prodhimi (rezultatet e drejtpërdrejta dhe të matshme);
- rezultatet (ndryshimet që çojnë në qëllimet përfundimtare);
- ndikimi (qëllimi përfundimtar, efekti i aktiviteteve).


SHKALLA

Pas vlerësimit fillestar të mundësisë dhe përcaktimit të një risie, që të ketë një ndikim të lartë, duhet të përcaktohet një mënyrë efektive për përhapjen e inovacioneve në sektorin shoqëror.

Ekzistojnë disa mënyra për të zgjeruar aktivitetet pjesëmarrëse të bujqësisë urbane:

- **Ndikimi** (dhënia e informacionit; ndërgjegjësimi për çështjet sociale dhe potencialet e qasjes);
- **Qasje e drejtpërdrejtë në riprodhim** (duke investuar në aftësitë organizative, përfshirja e përdoruesve të rinj, zhvillimi i vendeve të reja);
- **Shpërndarja** (mbështetja dhe sigurimi i informacionit, konsultimi dhe trajnimi, licencimi i metodës)

Përmes shpërndarjes, lobimit dhe degëzimit, të gjitha aktivitetet e përhapjes kontribuojnë në përmirësimin e rrethanave sociale të grupeve të përcaktuara.



NDRYSHIMI SISTEMATIK

Duke prezantuar një lloj të ri të shërbimit social, ripërcaktimin e pronësisë, zhvillimin e modeleve të reja të financimit ose lehtësimin e ekonomisë rrethore, bujqësia urbane pjesëmarrëse nuk do të përfundojë me kopshte urbane, por me një ndryshim në pozitën e përdoruesve të saj brenda sistemit shoqëror.

Përveç rritjes së perimeve dhe pjesëmarrjes, bujqësia urbane pjesëmarrëse ka të bëjë me krijimin e strukturave që sigurojnë dhe forcojnë gjerësinë dhe kohëzgjatjen e integritit të grupeve sociale të marginalizuara në shoqërinë urbane. Kjo mund të çojë në krijimin e një forme të re pjesëmarrëse dhe më gjithëpërfshirëse të ofrimit të shërbimeve sociale, ose mund të përfundojë me futjen e koncepteve të reja. Ajo mundet të lehtësojë edhe zhvillimin e një ekonomie rrethore në të cilën grupet e marginalizuara bëhen qendra e proceseve ekonomike; ose mund të eksperimentojë me kuptimet e ndryshme të përfitimeve për të papunët.

Bujqësia urbane pjesëmarrëse është një proces, jo një projekt. Ajo nuk duhet të përfundojë me krijimin e një kopshti, por duhet të zhvillohet vazhdimisht sipas nevojave, ndërkohë që monitorohen efektet dhe ndikimi i saj. Nëse është e suksesshme, atëherë ekziston mundësia për tu zgjeruar dhe për të rritur numrin e përdoruesve mbi të cilët ka ndikim. Dhe kështu, mund të shfaqet një vizion i ndryshimeve sistematike: një vizion afatgjatë që shkon përtej mbjelljes së perimeve.

Hapat drejt ndryshimit sistematik janë:

- **Miratimi**

Inovacioni paraqitet nga lojtarët e jashtëm, dhe pronësia mbi të është institucionalizuar gradualisht ose miratuar nga lojtarët relevantë në sistem.

- **Përshtatja**

Ndryshimet në sjellje të lojtarëve relevantë janë të qëndrueshme dhe ndryshimet tjera janë inkompatuar në operacionet standarde.

- **Reagimi**

Funksionet tjera mbështetëse dhe rregullat fillojnë të ndryshojnë në përgjigje të inovacionit.

- **Shtrirja**

Kufijtë zgjerohen. Thelbi i ndryshimit rritet dhe zgjerohet në drejtime të reja.

Publikimi: Qasja e Bujqësisë Urbane si një risi shoqërore


AgriGo4Cities ka përgatitur një publikim të titulluar "Qasja e Bujqësisë Urbane si një risi shoqërore: Udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e një plan veprimi". Publikimi paraqet lloje të ndryshme të mjeteve të planifikimit sistemik të cilat janë në gjendje për të integruar planifikuesit, praktikuesit dhe shoqërinë civile në një proces të përbashkët të mësimit që mund të udhëheqë në mënyrë efektive zhvillimin e bujqësisë urbane.

Kapitujt e librit përfshijnë arsyet e bujqësisë urbane, përfshirjen e grupeve sociale të marginalizuara, planifikimin me pjesëmarrje dhe përcaktimin e rolit të risive sociale. Në kapitujt e mëtejshëm, paraqitet çdo fazë e plan veprimit, së bashku me mjetet konkrete të planifikimit dhe shembuj të praktikës së mirë. Publikimi përfshin pikat kryesore nga të gjithë kapitujt dhe sqarime mbi llojet e Kopshteve Urbane. Elementi përfundimtar i botimit paraqet modelin Canvas të Bujqësisë Urbane, i cili është zhvilluar për të mbështetur procesin e plan veprimit.

Publikimi është në dispozicion në web faqen e AgriGo4Cities, në seksionin e Bibliotekës (<http://www.interreg-danube.eu/approved-projects/agriGo4Cities>).

Kopertina e botimit Bujqësia Urbane si risi shoqërore

Një shembull i praktikës së mirë në botim



Initiator: ProstoRož, Zavod Bunker
In collaboration with: Inštitut za politike prostora (IPOP)
More info: prostoroz.org/portfolio/items/park-tabor/

The Tabor Park project was built on the basis of a study prepared by the Bunker Institute, with the help of IPOP, which aimed to determine a strategy to revitalise the then-abandoned Tabor Park. The key problem was that local residents had avoided the degraded park. Following renewal of basic infrastructure and changes in the traffic regime, the initiators encouraged the local population to use the park and integrate it into their lives. This was done through a series of events that were held regularly between May and September during the project. Today, after the end of the project, the Tabor Park is still a lively public space, where local residents and visitors meet for self-organised events.

Lessons learned

The research identified key problems in the neighbourhood and the park, and also provided insight into the wishes and needs of local inhabitants and institutions. Renovation of the basic infrastructure and interventions in the traffic regime enabled the initiators to organise a variety of events that attracted the local population, encouraging them to participate and use the park. As a result of the conclusions of the research, regular events were organised for each week between May and September throughout the duration of the project. Thus, over four years, with the cooperation of one hundred and fifty organisations and individuals, 950 events took place. Among them were regular fairs, marketplaces, garage sales, seed exchanges and an outdoor cinema. Work campaigns were organised to clean the park and so encourage residents to take care of the area and continue their activities after the formal close of the project. The project served as a positive example of how to integrate local initiatives and develop them into sustainable strategies, and is still an inspiration and model for other similar initiatives in Slovenia.

Modeli Canvas i Bujqësisë Urbane

Burimet kryesore	Aktivitetet kryesore	Tipi i kopshtit urban	Çështja sociale	Propozime mbi vlerën
<p>Cilat burime kryesore kërkohen nga propozimet mbi vlerën?</p>	<p>Çfarë aktivitetesh kryesore kërkohen nga propozimet mbi vlerën?</p>	<p>Çfarë lloji të kopshtit urban do të përshtatet rastit tuaj (burimet kryesore, çështjet sociale, përfituesit)?</p>	<p>Cili është problemi social që po përpiqeni të zgjidhni? Cilat janë shkaqet e problemit? Cilët janë aktorët kyç (përfituesit, palët e treta, komunitetet) të lidhur me këtë problem shoqëror?</p>	<p>Çfarë vlere u jepni përfituesve? Cilin problem të përfituesit po përpiqeni të zgjidhni? Cilat nevoja të përfituesit po plotësoni?</p>
<p>Cilët janë partnerët tuaj kryesor? Kush janë furnizuesit tuaj kryesor?</p>		<p>Përmes cilave kanale do të kontaktohen përfituesit? Si jeni duke kontaktuar me ato?</p>	<p>Cilët janë aktorët kryesorë (përfituesit, palët e treta, komunitetet) të lidhur me këtë problem shoqëror?</p>	
<p>Cilat burime kryesore jeni duke siguruar nga partnerët? Cilat aktivitete kryesore kryejnë partnerët?</p>		<p>Cilat kanale funksionojnë më mirë?</p>		
<p>Cilat janë kostot më themelore të projektit tuaj? Cilat burime kryesore janë më të shtrenjta? Cilat aktivitete kryesore janë më të shtrenjta?</p>				

Të frymëzuar nga: Modeli Canvas i Biznesit Social - www.socialbusinessmodelcanvas.com

Mjet trajnimi për plan veprimin

Kaja Cunk

Me qëllim të përgatitjes së akterëve të ndryshëm (vendimmarrësve, nëpunësve publikë, përfaqësuesve të OJQ-ve, hulumtuesve) për plan veprimin, më 21 dhe 22 nëntor 2017, në Mynih u mbajt një seancë **transnacionale trajnimi** dy ditore.

Programi i seancës së trajnimit transnacional

AgriGo4Cities TRANSNATIONAL TRAINING SESSION DAY 1 21st November 2017	AgriGo4Cities TRANSNATIONAL TRAINING SESSION DAY 2 22nd November 2017
09:30-09:40 Welcome speeches	09:00-09:20 Training presentation
09:40-10:00 Project presentation	FOCUS: PARTICIPATORY PLANNING
10:00-10:20 Training presentation	09:20-09:40 Collective activities
FOCUS: URBAN AGRICULTURE	09:40-10:20 Lunch
10:30-10:40 Collective brainstorming	10:20-11:00 Lunch
10:40-11:20 Good practice presentation: SCENARIOS FOR PROMOTING VULNERABLE GROUPS IN THE PARTICIPATORY URBAN AGRICULTURE AND PRODUCTION IN ACTION PLAN (Dares Sala, São Paulo, Spain; Minsk Food Project)	11:00-11:20 Coffee break
11:20-11:40 Coffee break	11:20-11:50 Action planning session: IDEAS AND PROPOSALS
11:40-12:00 Action planning session: INTRODUCTION	11:50-12:20 Lunch
12:00-12:30 Lunch	FOCUS: SOCIO-ECONOMIC INCLUSION OF VULNERABLE GROUPS
14:20-15:00 Lunch	14:20-14:40 Visualisation of the users
15:00-15:40 Good practice presentation: PRODUCTION OF URBAN AGRICULTURE IN MARCH (Els van der Plaats)	14:40-15:20 Good practice presentation: IMPLEMENTATION THROUGH COMMUNITY GARDENS IN A HIGH-RISK NEIGHBOURHOOD (Elske Brink)
15:40-17:40 Action planning session: CHALLENGES	15:20-16:00 Lunch
17:40-18:00 Daily reflection	16:00-16:40 Method demonstration: BEST PRACTICE EXAMPLE OF PARTICIPATORY WORK IN COMMUNITY GARDENS: COLLECTIVE MAPPING (Els van der Plaats)
	16:40-18:00 Action planning session: PRIORITY Wishes
	18:00-18:30 Daily reflection

Projekti AgroGo4Cities ka në thelbin e tij qasjen pjesëmarrëse, dhe ka ndërmarrë masat e mëposhtme, që ti pasqyrojnë në seancën e trajnimit:

- Të gjithë partnerët e projektit ishin të ftuar për të propozuar ligjëruesit për seancat e trajnimit;
- Ligjëruesit duhej të siguronin titullin e leksionit, përshkrimin e tij të shkurtër dhe biografinë e tyre;
- U mbajt një votim dhe partnerët duhej të vlerësonin çdo leksion bazuar në nevoja dhe interese;
- Leksionet e vlerësuara si më të mira u përfshinë në seancën e trajnimit.

Pasi zgjedhjes së leksioneve, u zhvillua programi i seancës së trajnimit transnacional. Ai kishte për qëllim:

- Përvetësimin e të kuptuarit të **bujqësisë urbane pjesëmarrëse**;
- Zhvillimin e **aftësive për plan veprim** me shumë akterë të përfshirë në proces;
- Përdorimin e **metodave pjesëmarrëse** të njohura në seancën e trajnimit: brainstorming, planin e hapur, teknikat e të menduarit të projektimit dhe teknikat teatrale.

Trajnimi transnacional puna në grup, seancë në Mynih



Trajnimi është një mjet i mirëpritur **për t'i motivuar pjesëmarrësit** të fitojnë ose përmirësojnë aftësitë e reja, shumë të nevojshme për punën e tyre të ardhshme. Për më tepër, mjedisi ndërkombëtar i trajnimit mundëson shkëmbimin e përvojave ndërmjet pjesëmarrësve dhe si rrjedhim një kuptim më të mirë të temës së trajnimit dhe shumëllojshmërinë e qasjeve të mundshme. Me synim jo vetëm zhvillimin, trajnimi mund të përdoret vetëm për qëllimin e zbatimit të projektit AgriGo4Cities; **seanca e trajnimit u zhvillua si një mjet trajnimi, që mund të përdoret si i tillë, ose transformohet dhe riformulohet në formën e nevojshme.**

Të gjitha hapat e seancës së trajnimit janë përmbledhur në publikimin 'Përgatitja për Planin e Veprimit: Një përshkrim i seancës së trajnimit', i disponueshëm në web faqen e AgriGo4Cities, në seksionin e Bibliotekës (<http://www.interreg-danube.eu/approved-projects/ag-rigo4cities>). Të gjitha prezantimet e leksioneve janë ngarkuar në internet për përdorim të mëtejshëm, (https://drive.google.com/file/d/1mW0vFoznZDKr9eVWGj_IEHF_EREE-jN1hR/view).

Në botim, do të gjeni:

- Versionin përfundimtar të programit të seancës së trajnimit;
- Një përmbledhje të shkurtër të secilit leksion me listën e rekomanduar për lexim të mëtejshëm;
- Shpjegime të hollësishme për ushtrimet e përdorura (si brainstorming, reflektimi ditor, veprimi kolektiv dhe të ngjashme);
- Të gjitha fletëpalosjet që janë krijuar për seancën e trajnimit (programi, kornizën e planit të veprimit, kartelat e pyetjeve reflektive).


Kopertina e publikimit 'Përgatitja për Planin e Veprimit: Një përshkrim i seancës së trajnimit'



Prezantimi i ligjëratave në publikim



Prezantimi i ushtrimeve



Programi i tutorimit për planin e veprimit

Lucia Vačoková

Për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme profesionale për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit në zonat pilot, ENVICORP Sllovaki, në bashkëpunim me partnerët strategjik të projektit, zhvilloi një **program tutorimi**. Programi siguroi një konsulencë të qëndrueshme për partnerët territorialë në fazat kryesore të procesit të planit të veprimit si dhe gjithashtu përcaktoi mekanizmat dhe personelin përgjegjës për mësimin në fushat e:

- bujqësisë urbane,
- integrimin e qasjes pjesëmarrëse në vendimmarrje,
- Përfshirjen socio-ekonomike të grupeve të rrezikuara / të marginalizuara,
- Zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Programi i tutorimit së AgriGo4Cities

Programi i tutorimit është një nga rezultatet e zhvillimit të një metodologjie të përbashkët dhe objektivit i tij është të përmbledhë udhëzimet e ofruara nga tutorët për partnerët territorialë në procesin e hartimit dhe zbatimit të planit të veprimit.

Qëllimi i planeve të zhvilluara të veprimit ishte të gjeneronte një model të ri të qeverisjes me pjesëmarrje dhe të menaxhonte një kopsht ekzistues ose të krijonte një kopsht të ri urban nëpërmjet përfshirjes aktive dhe bashkëpunimit të grupeve të synuara. Komunitet në rrezik përjashtimi ishin të përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse. Ata hartuan modelet e tyre të angazhimit social dhe ekonomik (p.sh. ndërtimet në komunitet, ndërmarrjet sociale, prodhimi rajonal ushqimor dhe furnizimi i restoranteve, vende të të mësuarit, komunikimi dhe / ose kritikimi, përdorimi alternativ i hapësirave publike etj.) në përputhje me orientimet strategjike të qytetit.

Shërbimet e udhëzimeve profesionale janë ndërtuar mbi informacionin e specializuar të ofruar gjatë Seancës së Trajnimit Transnacional, të mbajtur në nëntor 2017, në Mynih dhe më vonë janë përmbledhur në Udhëzimet për Zhvillimin dhe Zbatimin e një Plan Veprimi. **Për udhëheqjen e partnerëve territorialë gjatë pilotëve, partnerët strategjikë kanë caktuar profesionistët e vet që ishin përgjegjës për një hap të veçantë të zhvillimit dhe zbatimit të planit të veprimit.** Gjatë programit mësimor janë kryer tre lloje aktivitësh: udhëzime për grupe, konsultime individuale dhe sondazhe.



Tabela përmbledhëse e metodave të përdorura për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit duke përfshirë llojet e konsultimeve:

	Metodat	Llojet e konsultimeve
Identifikimi	<p>Analiza statistikore Një ditë në jetë</p> <p>Harta e akterëve</p> <p>Hartat mendore</p> <p>Vëzhgimi i pjesëmarrësve</p> <p>Planifikimi me pjesëmarrje</p> <p>Analiza e pyetësorëve të vlerësimit dhe pyetësorit të inventarit</p> <p>Takimet dhe intervistat</p> <p>Zhvillimi personal</p>	
Ideimi	<p>Tabela me kolazhe MoSCoW</p> <p>Hartat mendore</p> <p>Pema e problemit</p> <p>Grupi i planifikimit</p> <p>Analizimi SWOT</p> <p>Pyetësorët e vlerësimit dhe pyetësori i inventarit</p> <p>Takime</p>	
Prototipi	<p>Dëshmi të testimit të konceptimit</p> <p>Prototipi i ngadalshëm</p> <p>Kriteret (në krahasim me PA-të tjera)</p> <p>Sondazhe me kopshtarë</p> <p>Punëtori</p> <p>Anketa mbi opinionin e banorëve</p>	<p>individuale: tel, email, Skype, personale</p> <p>Konsultime në grup</p>
Monitorimi	<p>Studimi i opinionit publik dhe marrja në pyetje e përdoruesve për aktivitetet</p> <p>Kriteret</p> <p>Dëshmi të testimit të konceptit</p> <p>Kartela e balancuar</p> <p>Auditimi social</p>	<p>sondazhe</p>
Shkallëzimi	<p>Zgjerimi i kapaciteteve të ofrimit të organizatës</p> <p>Përhapja e njohurive</p> <p>Ndikimi në ndërgjegjësimin publik</p> <p>Normat</p> <p>Sjelljet</p> <p>Asistenca teknike</p> <p>Konferenca ndërkombëtare,</p> <p>Përhapja në qytete të ngjajshme</p>	
Ndryshimi sistematik	<p>Metoda e Miratimit & Përshtatjes & Zgjerimit & Përgjigje</p>	

Zbatimi i programit të tutorimit

Thelbi i planeve të veprimit ishte zhvillimi i një kopshti urban me përfshirjen e partneriteteve lokale dhe grupeve të synuara. Çdo zonë pilot ka karakteristika dhe nevoja të ndryshme specifike. Pra, edhe pse **planet lokale të veprimit kanë strukturë të përbashkët dhe përdorin metoda të përbashkëta ose të ngjashme, ato përfaqësojnë plane individuale.**

Identifikimi paraqet hapin e parë në planin e veprimit. Pasi që komunat e kishin planifikuar këtë hap gjatë aplikimit për projekt, ata nuk kishin nevojë për shumë konsultime me tutorë. ZRC SAZU partnerët përgjegjës për këtë hap kanë marrë pyetje për çështjet e mëposhtme:

- Mbledhjen e informacionit statistikor mbi grupet e synuara,
- përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta,
- shpjegime se si qytetarët të marrin pjesë në planifikimin e kopshteve, çka nënkupton përfshirja sociale në praktikë dhe si të përfshihen të dy aspektet në kopshtarinë urbane,
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet akterëve,
- bindja e njerëzve se projekti do të ketë rezultate të frytshme,
- diskutimi i një date dhe kohe të përshtatshme për takimin e pjesëmarrësve,
- Organizimi i punëtorive tërheqëse dhe të lehta për t'u ndjekur.

Ideimi dhe prototipet ishin dy pikat kryesore në trajnimin transnacional në Mynih, gjatë të cilit partnerët strategjikë prezantuan dy hapa për partnerët territorialë dhe ofruan konsultime rreth tyre. **Faza e Ideimit bazohet në analizën dhe rezultatet e fazës së Identifikimit.** Gjatë Ideimit, u konsideruan dhe u vlerësuan skenarë të ndryshëm. Në kuadër të tutorimit, partnerëve pilot u anketuan përmes pyetësorëve rreth aktiviteteve të tyre të ideimit.

Bazuar në përvojat e tyre, **bashkëpunimi dhe një sërë pikëpamjesh janë thelbësore për të marrë rezultate më të mira.** Teknikët, popullata lokale, punëtorët, biznesmenët dhe zyrtarët publikë duhet të përfshihen të gjithë për të shpërndarë idetë si dhe për të diskutuar mundësitë dhe qasjet. Në përgjithësi, kjo fazë është një qasje e mirë për të parë projektet e planifikimit pjesëmarrës lokal, si dhe ato kombëtar dhe ndërkombëtar, të kryera në kontekste të ngjashme.

Prototipi u simulua me të gjithë partnerët territorialë në Mynih, përmes metodave të tryezës së rumbullakët, ku partnerët strategjikë ishin tutorë. Partnerët territorialë përdorën disa metoda për procesin e prototipit (vizatimi i kopshtit ose zhvillimi i modelit të kopshtit të vogël me përdorimin e përbërësve natyrorë dhe artificialë). Gjithashtu, u organizua prezantimi i rezultateve me mundësi të ndryshimit të informacionit.

Në fazën e dytë të zbatimit të programit të tutorimit, **grupi drejtues u përqendrua në diskutime grupore dhe punëtori, për të ndarë idetë dhe përvojat e tyre.** Në takimin e pestë të projektit, në Blagoevgrad, u organizua një diskutim në grup që drejtpërsëdrejti synonte tre hapat e fundit (monitorimin, shkallëzimin, ndryshimin sistemik). Në seminar u përdor metoda botërore e kafeneve, gjatë së cilës nga një tryezë u dedikua për secilin prej hapave. Në çdo tryezë, tutorët përgjegjës mbajtën diskutime rreth hapave të caktuar. Partnerët territorialë patën mundësinë **të ndajnë sfidat që kanë hasur gjatë aksioneve pilot, të pasqyrojnë tek njëri-tjetri dhe të kërkojnë udhëzime nga partnerët strategjikë.** Marrja e këshillave nga partnerët e tjerë, para hyrjes në fazat e fundit të pilotit, ishte e dobishme për partnerët territorialë. Përveç kësaj, punëtorja ofroi gjithashtu një pasqyrë për partnerët strategjikë në lidhje me aktivitetet në vazhdim.

Rezultatet e zbatimit të programit të tutorimit

Në kuadër të programit të tutorimit, partnerët strategjikë bashkëpunuan me ENVICORP-in Sllovaki, për zhvillimin e "Pyetjeve më të shpeshta" (FAQ), që është një nga rezultatet kryesore të zbatimit të programit të tutorimit. Më poshtë mund të gjeni një koleksion të pyetjeve më të rëndësishme që u shfaqën gjatë zbatimit të programit:

Identifikimi:

Si të rritet niveli i bashkëpunimit ndërmjet akterëve?

Bashkëpunoni me organizata të mirënjohura, individë nga kjo fushë ekspertize dhe referohuni atyre kur ftoni akterë të rinj në këtë proces. Gjithashtu, është më vend të nënkontraktohet një shoqatë nga terreni për të organizuar seminarët, dhe për të transmetuar rrjetin e tyre në projekt.

IDEIMI:

Si të siguroni një tokë të përshtatshme për kopshtin?

Mos kontaktoni drejtpërsëdrejti komunën, por kontaktoni dhe bashkëpunoni me këshilltarët e qytetit dhe organizatat relevante të fushës. Filloni planifikimin dhe bashkëpunimin sa më herët që të jetë e mundur.

PROTOTIPI:

Pse preferoj prototipin mbi planin e projektimit?

Prototipi është një metodë e thjeshtë për të vizualizuar një kopsht dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme në procesin fillestar. Avantazhi kryesor i prototipit, është se ka kosto më të ulët sesa një plan projekt, pasi nuk ka nevojë për një arkitekt të certifikuar ose një program të veçantë të projektimit. Në anën tjetër, përfundimi i një plani të dizajnit kërkon një projektues / arkitekt dhe kostot e ndërlidhura si dhe ndryshimet në planin e dizajnit rrisin kostot në përputhje me vështirësinë ose kompleksitetin e ndryshimeve që duhet të bëhen në plan.

MONITORIMI:

Cilat metoda duhet të përdorim?

Metodat gjithmonë duhet të bazohen në llojet e treguesve dhe grupeve të synuara. Ekzistojnë disa metoda matematikore që mund t'i përdorni kur punoni me të dhëna dhe numra, por nëse bëni intervista ose pyetësorë me anëtarët e grupeve tuaja të synuara duhet të zgjidhni një metodologji që i përshtatet nevojave të tyre. Për shembull, gjatë punës me njerëz të rrezikuar duhet të zgjidhni një metodologji interesante dhe të thjeshtë dhe të mos matni mendimin e tyre me pyetësor të gjatë që përdorin gjuhë të komplikuar.

SHKALLËZIMI:

Cilat janë parakushtet e nevojshme për të avancuar veprimin?

Jo çdo aktivitet duhet të avancohet. Parakushtet duhet të vlerësohen me kujdes gjatë planifikimit të zgjerimit. Duhet të vlerësoni shkallëzimin e idesë ose të projektit, ose nëse keni ndonjë gjë me vlerë për të avancuar.

Së pari, përcaktoni se çfarë e bën aktivitetin tuaj inovativ, çfarë e bën atë të suksesshëm dhe pse. Së dyti, vlerësoni nevojat ose nëse ka diku ndonjë nevojë të paplotësuar ose të plotësuar keq. Së treti, vlerësoni nëse keni mjaft mbështetje organizative dhe stabilitet. Sipas vizionit dhe qëllimeve të tuaja, krijoni një bazë të 'ndjekësve' dhe aleancave, dhe riformoni ose mobilizoni burimet. Së katërti, vlerësoni nëse kjo është koha e duhur për të eksploruar shkallën seriozisht.

NDRYSHIMI SISTEMATIK:

Cilat aspekte duhet të merren parasysh gjatë përpjekjes për të arritur një ndryshim sistematik?

- Korrespondenca (sistemet përparojnë nga rregullsitë)
- Fuqia (gjatë procesit të vendimmarrjes ushtrohet dhe zotërohet autoriteti dhe kjo nënkupton përgjegjësi)
- Rrjetet (rrjetet kanë potencial më të fortë për të ndryshuar)
- Shpërndarja (për të qenë një hyrje efektive duhet t'u përshtatet personave të interesuar)

ZBATIMI I BUJQËSISË URBANE PJESËMARRËSE NË ZONAT PILOT

Përshkrimi i zonave pilot

Jernej Tiran dhe Drago Kladnik

Pavarësisht se të gjitha zonat pilot i përkasin Rajonit të Danubit, ato dallojnë në shumë karakteristika të tilla si sipërfaqja dhe kushtet natyrore. Shumica e tyre janë të vendosura në zonat malore në lugina dhe pellgje, përveç Székesfehervár, sipërfaqja e të cilit është mjaft e sheshtë dhe është i vendosur në rrafshinë. Kushtet klimatike gjithashtu ndryshojnë shumë. Shumica e zonave pilot kanë klimë të moderuar kontinentale përveç Blagoevgradit, mbi të cilit ka ndikim të fortë klima mesdhetare.

Dallimet në dendësinë e popullsisë janë më karakteristike se sa kushtet natyrore.

Karakteristikat e përgjithshme të zonave pilot

Zona Pilot	Sipërfaqja (km ²)	Popullsia	Dendësia e popullsisë (njerëzit / km ²)
Praga 9	13,3	57,000	4286
Blagoevgrad	621	77,000	125
Székesfehervár	171	98,000	571
Vaslui	48	70,000	1460
Velenje	83,5	33,000	392

Rritja e popullsisë tregon dy modele të zhvillimit të popullsisë. Kryeqyteti i Çekisë, Praga ka një rritje të përhershme por të ngadalshme të popullsisë pothuajse gjatë gjithë periudhës pas vitit 1960. Në komunat e tjera, popullsia ishte në rritje deri në vitin 1990 ose 2000. Që nga ajo kohë, popullsia ka mbetur e njëjtë ose ka rënë deri në 8%.

Në zonat pilot mund të identifikohen tri **trende demografike** të zakonshme dhe ato korrespondojnë me pjesën tjetër të Bashkimit Evropian: rënia e numrit të përgjithshëm të lindjeve, plakja e popullsisë dhe zvogëlimi i riprodhimit natyror të popullsisë.

Me 41.6%, Bashkia e Pragës 9 ka përqindjen më të lartë të fabrikave urbane të ndërprera. Përqindja më e ulët është në Komunën e Blagoevgradit (2.6% dhe 1.8%). Zonat industriale, tregtare dhe të transportit dhe zonat e gjelbra urbane gjithashtu kanë përqindjen më të lartë në Pragë 9. Nga ana tjetër, pjesa e zonave bujqësore është më e lartë në Vaslui dhe Székesfehervár (me 71.3% dhe 63.5%), ashtu si pjesa e pyjeve dhe kënetave në Blagoevgrad dhe Velenje (65.8% dhe 53.3%).

Veçoritë më karakteristike të pesë zonave pilot përfshijnë:

- Ndërtesa bashkëkohore e prona të mëdha të banimit dhe zhdukja e industrisë në Bashkinë e Pragës 9,
- Roli i rëndësishëm i bujqësisë dhe pylltarisë në Blagoevgrad,
- Roli historik i Székesfehervár si kryeqyteti mesjetar i Hungarisë dhe një vend i kurorëzimit dhe varrimit të mbretërve hungarezë,
- Lloji i stepës pyjore i florës dhe faunës, edhe i parqeve të njohura në Vaslui,
- Minierat e qymyrit në qytetin e ri të Velenjes, një qendër e rëndësishme industriale e projektuar si një qytet me shumë kopshte.


Karakteristikat e bujqësisë urbane dhe periurbane në zonat pilot

Roli i bujqësisë urbane në zonat pilot mund të vërehet së pari duke shqyrtuar **kornizën lokale strategjike dhe legislative**. Nga ky këndvështrim, të gjithë partnerët mund të mbështeten në të paktën një dokument lokal, që lidhet me bujqësinë urbane. Megjithatë, shumica e dokumenteve nuk merren drejtpërdrejt me bujqësinë urbane. Ato zakonisht e prekin subjektin më mënyrë indirekte (p.sh. planet hapësinore dhe strategjitë e zhvillimit) duke theksuar fusha më të përgjithshme, si toka bujqësore ose zona të gjelbra përbrenda përdorimit të tokës, prodhimi i ushqimit dhe vetëmjaftueshmëria. Dallimi në mes bujqësisë urbane dhe asaj rurale nuk është i përcaktuar qartë. Raste të rralla me referencë konkrete për bujqësinë urbane mund të gjenden në Velenje, Blagoevgrad dhe Székesfehérvár.

Gjithsej, aktualisht ekzistojnë **32 vende bujqësore urbane** në zonat pilot. Rreth dy të tretat janë përmbledhur nën një kategori më të gjerë të "kultivimit të prodhimeve urbane", ndërsa pjesa tjetër i përket "bujqësisë urbane". Pjesa më e madhe e zonave pilot kanë shembuj të shumtë të bujqësisë urbane, dhe shumica e llojeve të identifikuar të bujqësisë urbane janë të përfaqësuara, me përjashtim të llojeve jo-konvencionale, siç janë feramat terapeutike dhe eksperimentale. Llojet më të zakonshme të bujqësisë urbane identifikohen si kopshte me ndarje, kopshte edukative, ferma për pushim dhe ushqimet lokale.

Bujqësia urbane nuk është një fenomen i kohëve të fundit në rajonin e Danubit, megjithëse një shtysë e re vihet re në dekadën e fundit. Historikisht, vendi i parë bujqësorë urban në zonat pilot të përzgjedhura është Kolonia e Zahrádkářská, Bashkia Pragë 9 (1945). Që atëherë, mund të dallojmë dy periudha të evolucionit të bujqësisë urbane. Vendet e atëhershme bujqësore urbane u ndërtuan në Vaslui pas Luftës së Dytë Botërore, në Székesfehérvár në fund të viteve 1960 dhe në Velenje gjatë viteve 1970. Në të tre qytetet, krijimi mund të shoqërohet me një kontekst socialist. Pas socializmit, u vu re një stagnim në bujqësinë urbane që zgjati deri në mijëvjeçarin e ri. Që nga viti 2000, një valë e re dhe më e fortë e projekteve të reja bujqësore urbane mund të zbulohet në shumicën e zonave pilot dhe kjo tendenca është ende në vazhdim.

Për projektet e reja bujqësore urbane, një bashkëpunim i akterëve të shumtë është më i zakonshëm sesa çishte përpara. Struktura e pronësisë është më e favorshme për komunitat. Tokat në tranzicion dhe zonat e gjelbërta janë ato që kryesisht kultivohen në formën e bujqësisë urbane. Në këto vende mund të arrihet me biçikletë dhe veturë dhe më me vështirësi me anë të transportit publik ose në këmbë. Më shumë se gjysma e vendeve bujqësore urbane janë të arritshme, ndërkohë që shumica e vendeve bujqësore urbane janë të pajisura me mjete të mëdha ose të vogla për tokën.



Shfaqja e kopshte urbane në zonat pilot

Planifikimi me pjesëmarrje në zonat pilot

Zbatimi i suksesshëm i qasjes pjesëmarrëse nuk është një detyrë e lehtë. Zakonisht nevojitet shumë **kohë dhe përpjekje për të siguruar që pjesëmarrja të bëhet pjesë përbërëse e çdo procesi të planifikimit**. Katër komuna (përveç Székesfehérvár) tashmë kanë zbatuar një proces planifikimi me pjesëmarrje dhe në dy raste rezultoi të jetë një përvojë pozitive.

Grupi i punës në seancën e trajnimit transnacional në Mynih



Komunitetet lokale janë në gjendje të marrin pjesë në të pesë fushat pilot përveç Pragës 9, e cila ka juridiksion vetëm mbi planifikimin e komunitetit (kryeqyteti është përgjegjës për çështjet strategjike), dhe janë të përfshirë në planifikimin e dokumenteve strategjike komunale dhe duket se nuk ka dallime të mëdha në mes të komunave nga ky këndvështrim. Komunat ndryshojnë më shumë në përdorimin e mjeteve për angazhimin e përfshirjes së komunitetit. Punëtorit, takimet ballë për ballë dhe platformat web janë metodat më të zakonshme (të përdorura në të 4 komunat); ato ndiqen nga mediat sociale dhe sondazhe konsultimi (të përdorura në 3 komuna).

Në përgjithësi, grupet e rrezikuara janë të përfshira në planifikim në një masë më të vogël- përfshirja e tyre raportohet në Blagoevgrad, Velenje dhe Vaslui. Megjithatë, vetëm në Blagoevgrad grupet e rrezikuara janë në qendër të vëmendjes dhe definohen në mënyrë më specifike - për secilin grup organizohet një seminar i veçantë ose punë në laborator. Në fushat pilot, përfshirja e komunitetit në planifikim është e ngjashme me atë të nivelit strategjik komunal.

Procesi i vendimmarrjes në të gjitha komunat është kryesisht një **proces nga "lartë-poshtë"**, që do të thotë se një veprim është iniciuar nga komuna me qëllim që të përfshijë drejtpërdrejt komunitetet lokale në zbatimin e tij.

Megjithëse, **iniciativat bazë** në disa raste promovojnë dhe inkurajojnë ndryshimet e miratuara nga komuna, asnjëra nga komunat nuk administron në bashkëqeverisje, ku komunitetet lokale dhe komunat do të ishin partnerë të barabartë. Komuniteti nuk është i përfshirë konkretisht në menaxhimin e tokës bujqësore urbane në pronësi të komunës.

Përfshirja sociale në zonat pilot

Bujqësia urbane mund të trajtojë disa dimensione të përjashtimit social, si prodhimi, konsumimi, ndërveprimi shoqëror dhe angazhimi politik. Aktivitetet gjithashtu ofrojnë mundësi për shumë forma të **ndërveprimit shoqëror**.

Kopshtaria urbane në Blagoevgrad



Grupet e rrezikuara, të përcaktuara si më të rëndësishmet në fushat ku jetojnë partnerët e projektit, janë të moshuarit, të ndjekur nga të papunët dhe njerëzit me të ardhura të ulëta. Disa grupe të rrezikuara tashmë janë të angazhuar në kopshtari, por kryesisht në nivel familjarë. Përveç kësaj, në rajonin e Danubit ekzistojnë disa forma të bizneseve dhe mekanizmave të cilat punësojnë ose inkurajojnë punësimin e grupeve të rrezikuara. Grupet e rrezikuara gjithashtu janë të përfshirë në arsimim në forma të specializuara ose të rregullta. Ato mund të marrin pjesë në programe të tjera arsimore jashtë arsimit formal. Disa grupe të rrezikuara kanë të drejtën e marrjes së transfertave sociale dhe gjithashtu të një ndihmë shtesë në situata emergjente. Përveç komunave, punojnë me to gjithashtu edhe disa OJQ ose shoqata vendore, kombëtare apo transnacionale. Përfshirja sociale mbështetet gjithashtu nga legjislacioni dhe strategjitë lokale.

Për më tepër, komunat sigurojnë mjete themelore për përshtatjen fizike të personave me aftësi të kufizuara, strehimore, shtëpi të sigurta, ndihmë profesionale dhe përpjekje për të komunikuar me të verbërit (përmes web faqeve të përshtatura), më të shurdhërit (përmes gjuhës së shenjave) dhe romët (në dialektin e tyre). Ata në përgjithësi kanë përvojë pozitive me përfshirjen sociale.

Zhvillimi i qëndrueshëm urban

Bujqësia urbane promovon ndjeshëm zhvillimin e qëndrueshëm urban. Të gjithë partnerët kanë të paktën një dokument lokal që promovon qëndrueshmërinë, megjithatë, paradigma e zhvillimit të qëndrueshëm është miratuar plotësisht vetëm në Velenje dhe Székesfehérvár, por me bujqësinë urbane si një nga mjetet për të **arritur qëndrueshmëri më të lartë** vetëm në qytetin e fundit.

Nga këndvështrimi ekonomik, zhvillimi i kopshtarisë urbane është pak a shumë në fazën fillestare. Numri i përlllogaritur i banorëve të përfshirë në kopshtarinë urbane është në shumicën e rasteve, më pak se 1% e popullsisë së përgjithshme.

Kopshti i brendshëm në një qendër ditore në Blagoevgrad



Mund të supozojmë se numri aktual i njerëzve që merren me kopshtari urbane është shumë më i lartë, sidomos nese marrim parasysh kopshtet familjare. Në Blagoevgrad, Velenje, Vaslui dhe Pragë 9, integrimi në ekonominë lokale arrihet përmes tregjeve vendore, të cilat zakonisht veprojnë një herë në javë.

Kopshtaria urbane në zonat pilot është më e zhvilluar nga aspekti social. Në zonat pilot, ekzistojnë dy shembuj të përdorimit të kopshtarisë urbane si një metodë mësimore: Qendra e Kujdesit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara "Zornitsa" dhe Shkolla Natyrore 'Tvoriltsi' për të gjithë fëmijët, të dyja në Komunën e Blagoevgradit. Një shembull i ngjashëm mund të gjendet në Velenje ku në shkollat fillore janë themeluar shtatë parqe edukative.

Ka pasur shumë pak aktivitete bujqësore që do të adresonin aspektin mjedisor të qëndrueshmërisë pavarësisht ndërgjegjësimit të përgjithshëm të partnerëve të projektit në lidhje me potencialin mjedisor të kopshtarisë urbane. Në praktikë, promovimi i parimeve të eko-kopshteve u raportua vetëm në Velenje dhe Székesfehérvár. E vetmja praktikë e mirë, nga aspekti i menaxhimit të mbetjeve, është raportuar në Velenje, ku komuniteti lokal ka organizuar riciklimin e mbetjeve në kopshte ndarëse dhe e përdor atë si një mundësi për të krijuar pleh organik .

Tabela e shpalljeve në kopshtet e Kunta Kinte, në Velenje



Testimi i metodologjisë së përbashkët të bujqësisë urbane pjesëmarrëse

Nela Halilović

Qëllimi i pilotëve ishte **të testonte metodologjinë e përbashkët të bujqësisë urbane pjesëmarrëse** të krijuar nga partneriteti i mëparshëm në projekt. Partnerët territorialë krijuan **partneritete lokale**, që kishin si detyrë kryesore zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit.

Në të pesë zona pilot, Blagoevgrad (Bullgari), Pragë (Republika Çeke), Székesfehérvár (Hungari), Vaslui (Rumani) dhe Velenje (Slloveni), partnerët i përgatitën planet e tyre të veprimit përmes një **qasje pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse**. Këto të fundit, mbledhën administratorët publikë dhe persona në rrezik përjashtimi dhe në këtë mënyrë krahasuan metodat nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart.

Qëllimi i planeve të veprimit të zhvilluara ishte të gjenerohej **një model i ri i qeverisjes me pjesëmarrje dhe të krijohej një kopsht i ri urban / periurban ose të menaxhohej ai ekzistues** nëpërmjet **përfshirjes aktive dhe bashkëpunimit të grupeve të synuara**. Komunitetet në rrezik përjashtimi ishin përfshirë në mënyrë aktive në procesin e plan veprimit. Ata hartuan modelet e tyre të përfshirjes sociale dhe ekonomike (p.sh. rikrijimin dhe ndërtimin e komunitetit, ndërmarrjet sociale, prodhimi rajonal i të mbjellave dhe furnizimi i restoranteve, vende të të mësuarit, komunikim dhe / ose kritikim, përdorimi alternativ i hapësirave publike etj), në përputhje me orientimet strategjike të qytetit.

Udhëheqësi i aktivitetit, komuna Velenje, ka përgatitur një model për planet e veprimit në lidhje me Udhëzimet për Zhvillimin dhe Zbatimin e planit të veprimit, i cili ishte baza për përgatitjen e planeve të veprimit gjatë gjithë kohës. Secili partner ka kryer të paktën tri punëtori me pjesëmarrje. Plani i veprimit u mbështet vazhdimisht nga partnerët strategjikë, përmes programit inovativ të tutorëve. Çdo plan veprimi duhej të përfshinte këto hapa:



FAZA ZERO:

Përgatitja e një plani paraprak të veprimit

Secili partner duhej të organizonte takimin e tij të parë të brendshëm me përfaqësuesit e partneritetit lokal, me qëllim caktimin e draftit të parë të plan veprimit. Në takim, ata diskutuan hapat e ardhshëm të zbatimit të çdo faze në përputhje me karakteristikat e tyre. Ata folën për përgjegjësitë, metodat, afatet kohore dhe kufinj të kohorë të secilës fazë.

FAZA E PARË:

Analiza

Secili partner territorial mblodhi informacione mbi situatën aktuale lidhur me zbatimin e veprimeve pilot në zonat e tyre. Përveç të dhënave statistikore strikte, ato përfshinë edhe rezultatet e pyetësorëve vlerësues. Ata kontrolluan dhe vlerësuan kushtet e kuadrit si dhe përmirësimet e planifikuara të instrumenteve të politikave (p.sh. rregullorja e re, plani hapësinor i përditësuar). Nga udhëzimet dhe metodat e rekomanduara, ata zgjodhën ato të cilat i përshtateshin më së miri kushteve të tyre për punëtori.

FAZA E DYTË:

Ideimi

Kjo fazë iu kushtua shkëmbimit të ideve, njohurive dhe pritjeve, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të merrnin vendime nga mundësi të ndryshme. Ideimi është faza e ndërmjetme në mes problemeve dhe zgjidhjeve dhe mund të kuptohet si një analizë gjithëpërfshirëse. Në kuadër të ideimit, për të diskutuar rreth pilotit, partnerët së bashku me përfaqësuesit e partneritetit lokal ftuan akterë lokal, që punojnë me grupe të rrezikuara. Punëtorja synonte të paraqiste analizën dhe të rriste ndërgjegjësimin për problemin, i cili duhet të zgjidhet duke zbatuar veprime pilotë.

FAZA E TRETË:

Prototipi

Faza e prototipit ishte dedikuar për mbledhjen e reagimeve nga përdoruesit e ardhshëm, ndërsa veprimet pilot janë ende në fazën e planifikimit. Kjo u realizua duke kryer dy (dhe të gjitha) punëtori, me grupet e synuara - përdoruesit e ardhshëm të kopshteve urbane. Në punëtori pjesëmarrësit

zhvilluan një plan konkret duke përfshirë mikro vendndodhjen, dizajnin etj, të zonës së bujqësisë urbane. Për punëtoritë secili partner zgjodhi metodën që i përshtatet më së miri kushteve lokale.

FAZA E KATËRT:

Monitorimi, Shkallëzimi dhe Shpërndarja

Qëllimi i fazës së katërt ishte planifikimi i të ardhmes nga veprimet pilot. Për ruajtjen e zbatimit të suksesshëm të veprimeve pilot në zonat lokale, është e rëndësishme të planifikohen aktivitetet të rregullta, të vendoset personeli përgjegjës dhe mjetet për të komunikuar monitorimin e progresit. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për shkallëzimin. Pjesëmarrësit u përpoqën të parashikojnë ndikimin e projekteve të tjera.

FAZA E PESTË:

Ndryshimi sistematik

Së fundmi, megjithatë shumë i rëndësishëm, ndryshimi sistematik është një fazë e pafund në të cilën partnerët duhej të mendonin për mësimet e nxjerra dhe se si ata do të mund ta ndryshojnë sistemin me njohuritë e fituara gjatë planit të veprimit dhe zbatimin e veprimeve pilot. Bujqësia urbane nuk duhet të përfundojë vetëm me kopshte urbane, por me një ndryshim në pozicionimin e përdoruesve të tij brenda sistemit social.

Si pjesë të plan veprimit partnerët territorialë **përfunduan të paktën tri punëtori me pjesëmarrje** dhe në bazë të rezultateve të këtyre punëtorive ata **hartuan plan veprimin e tyre lokal**, si rezultat të bashkëpunimit intensiv me akterë. Çdo plan veprimi është i ndryshëm në përputhje me kushtet e zonës pilot dhe është i shkruar në gjuhën e zonës. **Zhvillimi i plan veprimeve është çështja kryesore e veprimeve pilot**, pasi administratorët publikë ishin në gjendje të shfrytëzonin njohuritë e fituara në mjedisin transnacional të të mësuarit dhe në të njëjtën kohë, komunitetet në rrezik përjashtimi ishin në gjendje të theksonin dhe të ndiqnin idetë e tyre duke punuar në projektet lokale të bujqësisë urbane. Veprimet pilot kanë kontribuar në integrimin social-ekonomik të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara si dhe për një mjedis më të mirë urban, që janë edhe objektivat specifike të projektit.

Kopshti komunitar Paletka në Pragë 9, Republika Çeke

Barbora Kvačková

Praga 9 është përballur me një mundësi unike për të krijuar një kopsht komunitar, ku **qëllim kryesor është stabilizimi dhe forcimi i pozitës së grupit të rrezikuar**: nënat me fëmijë. Fazat e ndryshme të zbatimit të plan veprimit të projektit, kaluan ndryshe. Në këtë rast, faza Analizë, Ideimi, Prototipi dhe Monitorimi kaluan pa ndonjë çështje serioze, bashkëpunimi me grupet e rrezikuara dhe me partneritetet lokale ishte pak a shumë i lehtë dhe ekipi i projektit arriti të krijojë rezultate të vlefshme. Megjithatë, fazat e shkallëzimit dhe ndryshimi sistematik ishin shumë më të vështira për t'u zbatuar. Në këtë rast, këto faza ishin të lidhura me shumë eksperimente dhe pasiguri. Në këtë pikë është e vështirë të vlerësohen rezultatet e dy fazave të fundit, për shkak se rezultatet janë më tepër të një karakteri afatgjatë.

Grupi i synuar, ose me fjalë të tjera grupi i rrezikuar janë **kryesisht nënat e vetme me fëmijë**. Ata u zgjodhën për shkak të numrit të konsiderueshëm të anëtarëve të këtij grupi në rrethin e Pragës 9, me shpresën se një kopsht komunitar sjell një mënyrë të re për të forcuar dhe bashkuar anëtarët. Kopshti komunitar është një vend i përkryer për të kaluar kohën, për të mësuar, dhe për të takuar njerëz të rinj me probleme dhe nevoja të ngjashme, sepse hapsirat e gjelbërta dhe të qeta janë vende të sigurta për ndërveprimet shoqërore. Sidoqoftë, ekziston mundësia **që të zgjerohet grupi i synuar dhe të përfshihen të moshuarit** nga azilet aty pranë dhe **gjithashtu fëmijët nga kopshtet fqinjë** në mënyrë që të ofrohet arsimi për kultivimin e të mbjellave.

Në aksionin pilot u përfshinë akterë të ndryshëm të cilët janë të gjithë disi të angazhuar në projekt. Përveç grupeve të rrezikuara të përshkuara më lart, gjatë projektit u krijuan partneritete të rëndësishme. Për shembull, partneriti me OJQ-në Kokoza, një OJQ e re që ka për qëllim krijimin e një rrjeti për të gjitha kopshtet komunitare në Republikën Çeke, që u kontaktua për shkak të njohurive dhe mundësive të shkallëzimit.

Një bashkëpunimi i rëndësishëm u krijua edhe me Qendrën e Maternitetit Knoflík, e cila tashmë kishte një rrjet të madh të qytetarëve të Pragës 9, sidomos nëna me fëmijë, por nuk mund të ofronte mundësi për të kaluar kohë të lirë jashtë, duke rritur bimë të ndryshme. Ekipi i projektit ka gjithashtu një marrëdhënie të mirë **me Kopshtin e Fëmijëve Pod Krocínkou**, i cili ndodhet në afërsi të kopshtit komunitar. Fëmijëve u ofrua një mundësi që të mësojnë për mbjelljen e farave, ujitjen, rritjen dhe korrijen, dhe për ciklin ushqimor.

Për të mbështetur grupin e rrezikuar të përzgjedhur, u zbulua (duke përdorur metodat e rekomanduara) se **kopshti komunitar** do të ishte mënyra më e mirë e zbatimit të projektit të bujqësisë urbane. Për krijimin e kopshtit nevojitet **një vend ku grupi i rrezikuar do të ndihet i kënaqur, i sigurt dhe ku mund të kalojë kohë me njerëz me interesa, pozicione sociale, dhe nevoja sociale të njëjta**. Gjithashtu, kopshti komunitar duhet të shërbejë si një vend për edukim, ku do të jetë i mundur zgjerimi i njohuritë dhe aftësitë. Për më tepër, qëllimi kryesor ishte që kopshti të jetë një vend ku grupi i rrezikuar mund të formonte një rrjet dhe natyrshëm të ndërtonte një komunitet.

Punëtorja Publike – Metoda e Kolazheve (në Kopshtin për Fëmijë Pod Krocínkou)



Gjatë planit të veprimit, u organizuan disa punëtori publike ku u zbatuan disa aktivitete duke përdorur prezencën e përfaqësuesve të akterëve të ndryshëm për të kuptuar më mirë nevojat e një grupi të caktuar. Gjatë planifikimit, më interesante ishte **ndarja e kopshteve në grupe duke përdorur të gjitha materialet e ndryshme në mënyrë që të përfitohen pritjet**. Menjëherë pas kësaj, grupet shkëmbyen, diskutuan dhe vlerësuan skemat e kopshtit të grupit tjetër. Nga kjo u zbulua se idetë dhe nevojat e grupeve ishin mjaft të ngjashme.

Një nga sfidat më të mëdha ishte përmirësimi i **komunikimit ndërmjet qytetarëve të Pragës 9 dhe autoriteteve të Bashkisë**. Gatishmëria e përfaqësuesve të Bashkisë për të marrë pjesë në punëtoritë publike dhe rritja e numrit të takimeve të suksesshme publike, konsiderohen si arritjet më të larta. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që Bashkia ka nisur një ndryshim sistematik. Ky rregullim do të vijë shumë ngadalë dhe gjithashtu do të modifikojë Administratën e Bashkisë. Deri më tani, përfaqësuesit e Bashkisë e vlerësojnë kopshtin komunitar si një projekt të mirë - të cilin ata janë të gatshëm të mbështesin në të ardhmen.

Ceremonia e hapjes në kopshtin komunal Paletka



U krijua një kopsht komunitar mirëfunksionues. Shumica e pronarëve të pjesëve të kopshtit janë anëtarë të grupit të rrezikuar. Gjithashtu, u përfshinë edhe fëmijët nga Kopshti për Fëmijë dhe një nga bazamentet e kopshtit i takonte Shtëpisë së të Moshuarve. Kjo do të forcojë integrimin e të moshuarve në shoqëri. Përveç kësaj, kopshti ka marrë pjesë me sukses në një ngjarje të të gjithë Pragës (Zažit město jinak - Përjetoni qytetin ndryshe), me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit. Është planifikuar që koordinatorët e kopshtit të vazhdojnë me shkallëzimin dhe rjetëzimin e mëtejshëm. Një nga arritjet kryesore është komunikimi i mirë ndërmjet anëtarëve të grupit të rrezikuar dhe përfaqësuesve të Komunës në disa takime publike - një rrugë e suksesshme për komunikim të mëtejshëm ka filluar ndërmjet Komunës dhe anëtarëve të grupeve të rrezikuara. Nga kjo marrëdhënie e ndërsjellë ata krijuan besim dhe mirëkuptim me njëri-tjetrin.

Për krijimin e një kopshti komunitar, parakushti më i rëndësishëm është të kemi mbështetje e komunës. Kjo lloj mbështetjeje (kryesisht për tokën, mbështetje ligjore) është baza e domosdoshme për krijimin e kopshtit komunitar. Një parakusht tjetër shumë i rëndësishëm për një fillim efektiv është zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet fushave të ndryshme që ndihmojnë dhe mbështesin komunitetin. Të pasurit më shumë partnerë e bën më të lehtë mbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kopshtit komunitar. Siç u zbuluar gjatë krijimit të një kopshti komunitar, është jetësore të gjeshe dhe të zbulosh anëtarë të grupit të rrezikuar / grupit të synuar, të cilët do të marrin përgjegjësinë dhe do të udhëheqin kopshtin komunitar së bashku. Është e rëndësishme që anëtarët e caktuar të dinë nocionin e përgjegjësisë për të drejtuar / menaxhuar me sukses kopshtin dhe të projektojnë veten si udhëheqës të grupit.

Krijimi i kopshteve urbane në Velenje, Slloveni

Nela Halilović

Plan Veprimi për zhvillimin e kopshte urbane në Komunën Velenje, u zhvillua në gusht të vitit 2018 si pjesë e dokumentit Bujqësia Urbane për Ndryshimin e Qyteteve - Plan veprimi për krijimin e kopshtit komunitar. Plan Veprimi u përgatit me qëllim **krijimin e një kopshti komunitar të bazuar në dëshirat e përdoruesve të ardhshëm** - grupeve sociale të rrezikuara - si pjesë e qasjes pjesëmarrëse. Gjatë zbatimit u ndoqën udhëzimet e plan veprimit të hartuara në kuadër të projektit.

Në fillim të plan veprimit u krijua **partneriteti lokal** me dy organizata lokale të cilët punojnë me grupe të marginalizuara – Universiteti në Velenje dhe Shoqata Miqtë e Rinisë - së bashku me ekspertë të jashtëm në fushën e arkitekturës së peizazhit. U prezantua një afat kohor për zbatimin e secilës fazë gjatë përgatitjes së planeve të veprimit, me hapat dhe përgjegjësitë e secilit partner. Të tre organizatat grumbulluan **të dhënat e nevojshme për kopshtarinë urbane, situatën në fushën sociale dhe modelin aktual të qeverisjes së planifikimin hapësinor** në Velenje. Së bashku përgatiten një përshkrim të shkurtër mbi gjendjen aktuale në komunë.

Pas analizës, u organizua seminari i parë me përfaqësues të organizatave që punojnë me grupe të rrezikuara në Velenje - Shoqata Miqtë e Rinisë, Qendra Rinore, Universiteti, Kopshti i Fëmijëve, Qendra e Kujdesit për Familjen dhe për të Moshuarit, Qendra për të pastrehët, Shoqata për njerëzit me vështirësi në zhvillimin mendor etj. Pjesa e parë teorike kishte për qëllim të paraqiste rezultatet e analizës në lidhje me temat e projektit - kopshtarinë, zhvillimin e qëndrueshëm, kushtet sociale dhe qasjen e planifikimit me pjesëmarrje.

U prezantuan praktikatat e mira në lidhje me tema të ngjashme. Qëllimi i pjesës së dytë të punëtorisë ishte ideimi, i cili është një fazë e ndërmjetme në mes problemeve dhe zgjidhjeve. Pjesëmarrësit vendosën për metodat e përfshirjes së grupeve të rrezikuara në kopshtari. Përmes diskutimeve ekipi i projektit mori një pasqyrë të mendimit të tyre mbi kopshtarinë urbane, si një metodë për të përfshirë grupet e rrezikuara në vendimmarrje dhe planifikim hapësinor, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Krijimi i hartës mendore me akterë, rreth arsyeve së pjesëmarrjes në kopshtarinë urbane



Faza e prototipeve përfshiu tre punëtori me grupe të rrezikuara, si shfrytëzues të ardhshëm të kopshteve urbane, me qëllim zhvillimin e një plani konkret për kopshtet e ardhshme komunitare. Të gjitha punëtoritë u organizuan në **mënyrë joformale**, pa rregulla strikte, **për t'i bërë pjesëmarrësit të ndihen rehat dhe kështu t'u lehtësohet anagazhimi**. Në seminarin e parë, ekipi i projektit diskutoi me emigrantët rreth kopshtit të tyre të ëndërrave - atë që ata do të mbillnin dhe përveç zbulimit të nevojave të tyre, ata mësuan disa fjalë të reja sllovene. Në punëtorinë e dytë u ndërtuan modelet e 'kopshteve të ëndërrave' në grupet ndërgjenerale. Në seminarin e tretë, kopshtet u ndërtuan jashtë, për të shikuar mikro vendndodhjen e kopshtit komunitar. Ekipi i projektit ka biseduar me më shumë se 150 banorë, emigrantë, fëmijë, të rinj, të moshuar etj. Kjo ishte një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të kopshteve të reja urbane.

Planifikimi me pjesëmarrjen e brezave të ndryshëm i kopshtit komunitar



Plani i parë për zhvillimin e dy, kopshteve më të mëdha komunitare, iu përshtat nevojave të pjesëmarrësve. Së bashku u vendos që një kopsht i madh publik do të ndërtohet përpara ambienteve të njërit prej partnerëve lokalë, Shoqatës së Miqve të Rinisë në Velenje dhe një lloji i kopshtit me shpërndarje, me baza të larta, përpara organizatave të ndryshme, për nevojat e tyre vetiake - Kopshti Lokal për Fëmijë në Velenje, Qendrës së Kujdesit për të moshuarit dhe Shkollës për Fëmijët me nevoja të veçanta. Përveç kësaj, komuna do të përpiqet të marrë disa fara bimësh, pajisje të reja, etj, për organizatat të cilat kanë kopshte, Qendra për të pastrehët dhe Qendra për të rinjtë. Përveç punëtorive, **u organizuan takime shitesë** me akterë, me qëllim përceptimin më të hollësishëm të punës së tyre. **Sipas nevojave, për secilin kopsht, do të ofrohen**, për shembull, për disa vetëm bimë dhe për të tjerët perime të ndryshme ose lule. Së bashku me grupet e rrezikuara, dhe ekspertët e mikro mjedisit, u vendosen mjete administrative, (p.sh menaxhimi ardhshëm i kopshteve dhe pronësinë), që të garantohet se kopshtet do të ekzistojnë edhe pas mbarimit të projektit.

Pas çdo seminari të mbajtur, u përgatit një raport me analizën e rezultateve. Raporti u përpilua nga të dhënat e përgjithshme - numri i pjesëmarrësve, metodat e përdorura, rezultatet dhe vlerësimi që është bërë gjatë punëtorisë. Ekipi i projektit mori gjithçka në konsideratë gjatë planifikimit të punëtorisë së ardhshme.

E vetmja fatkeqësi ishte se **zbatimi i ideve nuk u bë menjëherë pas planifikimit, kur motivimi i pjesëmarrësve ishte më i larti**. Ekipi i projektit do të mbajë kontakte me grupet e rrezikuara dhe para hapjes zyrtare të kopshteve më 22 prill 2019; - Në Ditën Botërore të Tokës, secila organizatë do të mbjellë bimët e veta me ekspertë të fushës. **Promovimi është bërë** dhe identiteti i korporatave të rezultateve u kosiderua, që do të jenë të dukshme jo vetëm në kopshte, por edhe në shtëpitë e shumë banorëve me një kalendar mbjellës për krijimin e 'kopshtit në ballkon'. Me shumë energji, plan piloti në Velenje i plotësoi objektivat e projektit: Përmirësimi i kapaciteteve institucionale publike, Rritja e përfshirjes socio-ekonomike të grupeve të rrezikuara / të marginalizuara dhe promovimi i zhvillimit të gjelbër urban nëpërmjet formave të reja të bujqësisë urbane.

Akterët, vendimmarrësit, grupet e rrezikuara dhe ekspertët - **të gjithë mësuan qëllime dhe metoda të reja**, veçanërisht për mbështetjen e përfshirjes së banorëve në proceset e vendimmarrjes. Nga ana tjetër, banorët u nxitën të aktivizoheshin në ato lloje të proceseve. Kapaciteti i komunës u ndërtua, edhe nëse komuna është përpjekur për shumë vite të zbatojë qasjen e planifikimit me pjesëmarrje, do ta përmirësojë atë me njohuritë nga projekti.

Kopsht komunitar dhe edukativ për nxënësit me vështirësi në të mësuar dhe sjellje në Székesfehévár, Hungari

Máté Szalók dhe Csaba Bende

Agjencia Qëndrore Transdanubiane e Inovacionit Rajonal (CTRIA) zbatoi aksionin pilot të Hungarisë në Székesfehévár. Qyteti me një histori të pasur tani është selia e Qarkut Fejér dhe qendra ekonomike e zonave përreth. Falë prosperitetit ekonomik, qyteti po zhvillohet shpejt, dhe këtu luan një rol aktiv qeveria lokale.

Bazuar në hulumtimet e mëparshme në projekt, **në Székesfehévár ka përpjekje për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje**, megjithatë ato nuk janë të bazuara në një strategji gjithëpërfshirëse dhe rrallë adresojnë grupe të caktuara, siç janë grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara. Bujqësia urbane ekziston edhe në qytet; megjithatë, nuk është pjesë e drejtpërdrejtë e strategjive të planifikimit urban dhe shihet rrallë si një mjet për përfshirjen sociale dhe ekonomike. Plan piloti hungarez ka për qëllim të testojë metodologjinë e bujqësisë urbane pjesëmarrëse në Székesfehévár, **me përfshirjen e spektrave të gjera të grupeve të synuara dhe si rrjedhojë ai ofron një model për vendimmarrësit dhe akterët e tjerë.**

Në Székesfehévár, partnerët hungarezë bashkëpunuan me Shkollën Speciale Arany János për të kryer aksionin pilot. Kjo është një shkollë e mesme e cila ofron disa programe të arsimit profesional për fëmijët me vështirësi në mësim dhe sjellje; disa prej tyre kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me bujqësinë urbane në fusha të tilla si kopshtaria, shitja e luleve dhe trajnimi i stafit të kuzhinës. Pas identifikimit të nevojave të shkollës dhe përputhjes së tyre me mundësitë që ofron projekti, partneriteti lokal vendosi **të krijojë një kopsht komunitar dhe edukimi i cili mund të përdoret në arsimin e përditshëm dhe mund të shërbejë gjithashtu si një vend komuniteti për nxënësit e shkollës.**

Trajnimi ndërkombëtar në Mynih ishte një hap i rëndësishëm përpara fillimit të aksionit pilot; rezultoi shumë i dobishëm dhe efektiv sa që disa përfaqësues të partnerëve lokalë morën pjesë në trajnime dhe ndihmuan gjatë fazës planifikuese të pilotit.

Gjatë zbatimit të veprimit pilot Agjencia ndoqi udhëzimet e AgriGo4Cities dhe në bazë të tyre u organizuan tri punëtori për planifikimin e kopshtit. Në punëtorinë e parë përfaqësuesit e shkollës, këshilltarët e qytetit, përfaqësuesit e shërbimit të mirëmbajtjes së qytetit dhe përfaqësuesit e OJQ-ve u mblodhën për të zhvilluar një vizion të përbashkët dhe për të diskutuar hapat e ardhshëm të veprimit pilot, veçanërisht mënyrën e përfshirjes së nxënësve.

Përgatitja e prototipit të kopshtit



Në punëtorinë e dytë - përveç përfaqësuesve të organizatave partnere - Agjencia ftoi studentët që janë përdoruesit dhe përfituesit përfundimtarë të kopshtit. Në fazën fillestare, drejtuesit e punëtorisë u përpoqën **të krijonin një mjedis miqësor** me anë të një prezantimi të shkurtër dhe interesant, në lidhje me komunitetin dhe kopshte edukative. Pastaj studentët u ndanë në grupe dhe punuan së bashku me akterët e ftuar në **përgatitjen e një prototipi** të një kopshti urban ideal. Për këtë veprim atyre u ofruan materiale të ndryshme (letra me ngjyra, ngjitëse, etj.), për punë krijuese. **Punëtorija krijuese** rezultoi e suksesshme, pjesëmarrësit e pëlqyen punën e përbashkët dhe zhvilluan kopshte prototip të hartuara nga vetë studentët.

Në kuadër të punëtorisë së tretë Agjencia organizoi një turne të shkurtër për pjesëmarrësit në një nga dy kopshtet komunitare në Székesfehérvár. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që t'u jepte atyre mundësinë për të provuar punën e kopshtarisë, t'i angazhonte ata në punët e kopshtarit për të fituar ide mbi menaxhimin e komunitetit dhe kopshtit edukativ, i cili u krijua në fazën tjetër të pilotit.

Bazuar në rezultatet e punëtorive u zhvillua organizimi përfundimtar i kopshtit dhe plani i punës së krijimit. Vlen të përmendet **se qasja pjesëmarrëse u theksua gjithashtu gjatë krijimit të kopshtit**. Studentët e përfshirë dhe akterët e tjerë e ndërtuan kopshtin së bashku me ekipin e projektit dhe kjo ishte një mundësi e madhe **për të forcuar përfshirjen** e pjesëmarrësve në projekt. Bashkëpunimi ishte një çështje kyçe në pilot; në këtë frymë, materialet ndërtuese për kopshtin u dhuruan nga kompanitë vendase.

Me një përpjekje të përbashkët, kopshti komunitar dhe ai edukativ u ndërtuan të dy në një ditë. Për të festuar suksesin e procesit dhe për të shpërndarë rezultatet, Agjencia organizoi ditën e hapjes në kopsht, ku ishin të ftuar të gjithë ato që morën pjesë në fazën e planifikimit dhe ndërtimit. Përveç tyre, Agjencia ftoi mediat lokale dhe studentët e shkollave të tjera në Székesfehérvár.

Disa muaj pas krijimit të kopshtit ekipi i projektit bëri një studim të shkurtër ndërmjet studentëve. Nga studimi mund të konkludojnë se nxënësit e pëlqenin planifikimin dhe ndërtimin e kopshtit. Ata **shpesh e vizitojnë atë gjatë ditëve të mësimt, kujdesen për të dhe gjithashtu zhvillojnë orë mësimi në kopsht**. Mbajtja e kontaktit me grupet e synuara në periudhën pas krijimit të kopshtit është e rëndësishme sepse ndihmon në ruajtjen e energjisë dhe i mundëson ekipit të projektit të monitorojë ndikimin afatgjatë të procesit.

Veprimi pilot në Székesfehérvár ishte një projekt i suksesshëm në shkallë të vogël, gjatë të cilit u testua metoda e AgriGo4Cities e bujqësisë urbane pjesëmarrëse. Veprimi pilot ishte i suksesshëm, mësimet e mësuara mund të përdorëshin dhe shfrytëzoheshin me qëllim promovimin e planifikimit me pjesëmarrje, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban në qytet. Nga njëra anë, **metodat e planifikimit pjesëmarrës, me objektiv të veçantë përfshirjen e grupeve të rrezikuara, dëshmoi të jetë një mjet efektiv në planifikimin urban**, i cili mund të përdoret në të ardhmen sidomos në rastin e planifikimit të komunitetit. Nga ana tjetër, **mundësitë e bujqësisë urbane për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm urban mund të shfrytëzohen duke krijuar kopshte edukative në oborret e shkollave**. Aksioni pilot i AgriGo4Cities ishte një projekt i vogël, por duke u mbështetur në rezultatet e tij mund të kontribuojë në arritjen e qëllimeve më të mëdha shoqërore dhe mjedisore.

Dita e hapjes së kopshtit



Kopshtari për të gjithë në Komunën Vaslui, Rumani

Stefan Dudau, Bogdan Ciubotaru dhe Cristina Dumbravă

Gjatë plan veprimit, Komuna Vaslui u mbështet në rezultatet e mëparshme të projektit AgriGo4Cities. Zhvillimi i konceptit të bujqësisë urbane pjesëmarrëse dhe seancës ndërkombëtare të trajnimit, e ndihmoi ekipin e projektit për të zbatuar veprimin pilot, me përfshirjen e një **numri të gjërë akterësh**: departamentet përkatëse të komunës, shërbimet sociale dhe autoritetet konsultative të rinjve dhe të moshuarve.

Ekipi i projektit mori pjesë në seancën e **trajnimit transnacional** në Mynih ku u prezantuan bazat e plan veprimit. Pjesëmarrësit hartuan plan veprimin, që përbëhej nga një titull i përzgjedhur - Kopshtaria për të gjithë - një listë të aktorëve pjesëmarrës dhe përfshirjen e tyre, kohëzgjatjen e parashikuar të plan veprimit (deri në arritjen e qëllimeve nga formulari i aplikimit). Ekipi përgatiti një **përshkrim të situatës aktuale të bujqësisë urbane në Vaslui dhe përshkruan grupet e synuara të përzgjedhura**. Ata vendosën indikatorët fillestar të prodhimit dhe planifikuan aktivitetet që duhet të kryhen për të arritur qëllimet e përcaktuara. Gjithashtu, renditën inputet e nevojshme si burimet financiare, njerëzore dhe materiale për kryerjen e procesit të planifikimit me pjesëmarrje.

Plan veprimi dhe zbatimi i veprimeve pilot synonin arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

- Përmirësimin e praktikave institucionale,
- Ndërtimin e një sheshi për mësim,
- Sigurimin dhe shitjen e ushqimit për grupet e rrezikuara,
- Shkëmbimin e njohurive,
- Integrimin social të grupeve të rrezikuara,
- Krijimin e shoqatës së grupeve të rrezikuara.

Si hap i parë i aksionit pilot, u krye një analizë më e thellë mbi ndikimet e mundshme të plan veprimit në grupet e synuara - që përbëhen nga të moshuarit dhe fëmijët . Siç është vërejtur tashmë, shumë të moshuar janë të aftë të jenë të pavarur, megjithatë të tjerët kërkojnë më shumë kujdes. Si rezultat i faktit që të moshuarit tipikisht nuk punojnë më, mund të ndodhin sfida financiare. Ata përballen me shumë sfida në jetën e tyre të mëvonshme, por ato nuk duhet të hyjnë në fazën e pleqërisë pa dinjitet. Nëpërmjet këtij projekti, Komuna Vaslui do të përpiqet të **ruajë dhe njëkohësisht t'iu kthejë përsëri dinjitetin personal që të moshuarit meritojnë për punën që kanë bërë dhe njohuritë që kanë fituar gjatë tërë jetës**.

Punëtorja e plan veprimit me të moshuarit



Me përfshirjen e fëmijëve, piloti synonte të mbështeste **zhvillimin e aftësive të tyre shoqërore që përfshin të mësuarit e vlerave, njohurive dhe aftësive** që u mundësojnë atyre të lidhen me të tjerët në mënyrë efektive dhe të kontribuojnë në mënyra pozitive për familjen, shkollën dhe komunitetin. Të pasurit e një identiteti të fortë kulturor rrit vetëdijen e fëmijëve dhe nxit ndjenjën e lidhjes dhe përkatësisë. Identiteti kulturor i fëmijëve ushqehet kur mësojnë për traditat e tyre kulturore dhe kur njerëzit rreth tyre tregojnë respekt për vlerat kulturore. Për këtë arsye, të mësuarit e fëmijëve për të respektuar dhe vlerësuar variacionet dhe dallimet midis kulturave është i rëndësishëm për të gjithë zhvillimin social të tyre.

Fëmijët nga grupet e pakicave mund të ndeshin dallime mes rregullave dhe pritjeve që kërkohen në shkollë dhe atyre që kanë mësuar në shtëpi.

Dallimet që nuk njihen ose injorohen dhe traditat e minimizuara kulturore që fëmijët identifikojnë, ndikojnë negativisht në identitetin kulturor dhe ndjenjën e përkatësisë së fëmijëve.

Punëtorja për plan veprimin me fëmijët



Me përfshirjen e akterëve dhe përfaqësuesve të grupeve të rrezikuara të përmendura, komuna Vaslui organizoi 3 seminare në Qendrën e të Moshuarve Buna Vestire dhe në Qendrën Ditore Bucuria. Të dy qendrat janë nën administrimin e Departamentit të Ndihmës Sociale, komuna Vaslui. Me organizimin e punëtorive në vendtakimet e akterëve dhe me **krijimin e një mjedisi të njohur dhe të rehatshëm** u mundësua përfshirja e grupeve të synuara. Rezultati kryesor i punëtorive ishte angazhimi i akterëve kryesorë në bujqësinë urbane. Ata patën rastin të shihnin prezantimin për një kopsht të ngjashëm, të bënë pyetje dhe të paraqitnin kopshtin e tyre imagjinar për një praktikë të ngjashme bujqësore urbane, për të cilën ata do të kontribuonin.

Në punëtoritë u shfaqën një sasi e madhe e ideve dhe u zhvilluan shumë diskutime për mënyrën se si duhet të zhvillohet bujqësia urbane në qytetin Vaslui. Për një qëndrueshmëri është e rëndësishme që kopshti të krijohet sipas asaj që kanë imagjinuar grupet e synuara. Pikëpamja e ekipit të projektit ishte **përfshirja e përfituesve në të gjitha seancat e periudhës së trajnimit, si teorikisht ashtu edhe praktikisht.**

Të gjitha aktivitetet u kryen së bashku me komunën, duke marrë parasysh kushtet lokale të grupeve të rrezikuara, bazuar në informacionin e ofruar nga akterët. Pjesëmarrësit punuan në grupe për të zhvilluar plan veprimin dhe në fund të procesit **objektivat janë vërtetuar nga të gjithë anëtarët e grupit.**

Përfundimet u përmbledhën në planin e veprimit me titull "Kopshtari për të gjithë". Një nga pjesët më sfiduese të punëtorive ishte kur ekipi i projektit duhej të paraqiste idenë e një kopshti urban, që ishte pak teorike dhe e vështirë për t'u kuptuar për disa kategori të grup moshave. Pjesëmarrësit më të mëdhenj e panë këtë aktivitet si individual, jo shoqëruar, dhe meqë nuk janë mësuar të punojnë në grupe, ata tentojnë të punojnë vetëm. Një sfidë tjetër e vështirë ishte **se si t'i vendosim njerëzit të punonin së bashku për të arritur objektiva të përbashkëta dhe jo individuale.** Në rastin e personave të moshuar, ekipi i projektit kishte diskutime interaktive, ku ju drejtonin pyetje për të mos humbur interesimin e tyre gjatë prezantimit të idesë. Për grupin e fëmijëve, ata paraqitën gjithçka si një histori të përshtatur për moshën e tyre dhe u treguan atyre shumë fotografi. Për më tepër, u bë e qartë se për një pilot projekt të tillë, ka rëndësi të madhe vendosja e një sërë rregullash dhe aktiviteti duhet të organizohet mirë për të arritur rezultatet e propozuara për kopshtin.

Aktualisht (shkurt 2019), kopshti urban nuk është themeluar ende, por do të bëhet në muajt e ardhshëm të projektit. Megjithatë, tashmë mund të nxirren përfundime të rëndësishme. Pjesëmarrësit e aksionit pilotit, nga secili grup i synuar - vendimmarrësit, grupet e rrezikuara dhe akterët e tjerë - kanë fituar shkathtësi të rëndësishme dhe mirëkuptimi mes tyre është rritur. Përfaqësuesit e komunës mësuan rreth planifikimit më pjesëmarrje në teori dhe në praktikë, dhe kjo u mundëson atyre të rrisin cilësinë e shërbimeve publike dhe kapacitetet e institucioneve publike.

Kopshti periurban për të moshuarit dhe fëmijët me nevoja të veçanta në Blagoevgrad, Bullgari

Simana Markovska

Bullgaria është një vend tradicional rural dhe bujqësor. Për këtë arsye, **koncepti i kopshtarisë urbane është një koncept i ri** dhe madje i çuditshëm për shumicën e bullgarëve dhe praktikata e mira në këtë fushë nuk janë aq të zakonshme. Kjo ishte pika fillestare për Shoqatën e Komunave Jugperëndimore (ASWM), kur nisi iniciativën e bujqësisë urbane lokale në qytetin e Blagoevgradit. Një tjetër aspekt bazë i situatës ishte **gatishmëria e qeverisë lokale për të zgjeruar përpjekjet e saja në përfshirjen e personave lokal dhe grupeve të ndryshme sociale në dialog dhe bashkëpunim** për të ardhmen e qytetit dhe të rajonit. Aspekti i tretë ishte **ekzistenca e grupeve lokale të rrezikuara** me nevoja specifike, shumë prej të cilave janë të përfshira në politikën sociale të Komunës por ende ka nevojë për më shumë vëmendje dhe kujdes.

Në këtë situatë, Shoqata e Komunave Jugperëndimore filloi të zbatonte në nivel lokal qasjet e AgriGo4Cities, duke dhënë një 'fotografi të momentit' **të mundësive në bujqësinë urbane, nivelet e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, si dhe nevojat dhe kufizimet e grupeve të rrezikuara sociale**. U krijuan kontakte me përfaqësues të këtyre grupeve, me organizatat e tyre (aty ku ekzistonin), institucione të ndryshme të specializuara dhe ekspertë. Dy grupe specifike të synuara u përzgjedhën për iniciativën pilot brenda projektit AgriGo4Cities: fëmijët me nevoja të veçanta dhe të moshuarit. **Partneriteti lokal u formua zyrtarisht** në fund të vitit 2017, duke përfshirë përfaqësuesit e Komunës së Blagoevgradit, Shoqatën Vendore të Pensionistëve, Qendrën e Kujdesit Ditorë Zornitsa për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe disa shoqata dhe institucione lokale që punojnë në fusha të ngjashme.

Këta partnerë punuan së bashku në gjysmën e parë të vitit 2018, për të zhvilluar një Plan Veprimi Urban dhe PeriUrban të Bujqësisë për zonën pilot të Blagoevgradit. Ai përfshinte **organizimin e tre punëtorive të njëpasnjëshme dhe disa takimeve të ndërmjetësimit**, dhe ishte i strukturuar në gjashtë faza, të përbashkëta për të gjitha fushat pilot të AgriGo4Cities: Identifikimi, Ideimi, Prototipi, Monitorimi, Shkallëzimi dhe Ndryshimi Sistemik.

Punëtorja e plan veprimit me akterë



Para fillimit të procesit të planifikimit, u bë një analizë dhe vlerësim i nevojat specifike dhe kufizimeve të grupeve të synuara. **Metodat e përdorura janë marrë nga Udhëzimet e AgriGo4City** për Zhvillimin dhe Zbatimin e një Plan Veprimi - "Zhvillimi Personal" dhe "Një Ditë në Jetën e ...". Gjatë punëtorisë së parë, në maj 2018, pjesëmarrësit vizatuan së bashku një Hartë të Akterëve dhe diskutuan vendndodhjen fizike (gjeografike) dhe organizimin e një kopshti pilot urban / periurban në Blagoevgrad. U vendos që kopshti të jetë i karakterit 'kolektiv' i përbërë nga dy ose tre komplete të ndryshme në zonën periurbane të Dabravës dhe duke kombinuar pronësitë komunale dhe private.

Punëtorja e dytë, në fillim të qershorit 2018, u mbajt në dy seanca, ku dy grupet e synuara bënë një prototip të kopshtit të ardhshëm. Të moshuarit përdorën metodat e të menduarit krijues "Lotus Blossom" dhe "MoSCoW", për të nxjerrë ide për bujqësinë urbane dhe periurbane dhe **përfshirje më të gjerë të publikut**, ndërsa fëmijët me nevoja të veçanta bënë disa **modele krijuese të kopshtit të tyre të dëshiruar**. Seminari i tretë, fundi i qershorit 2018, përmbledhi të gjitha idetë dhe ndihmoi partnerët lokalë për të formuluar një Plan Aktual Veprimi, për iniciativën pilot të Blagoevgradit.

Aktivitetet e para për zbatimin e pilot-it u zhvilluan në fillimin e vjeshtës së vitit 2018. Një **markë e veçantë u zhvillua për etiketimin dhe promovimin e prodhuesve të vegjël bujqësorë nga zona periurbane e Blagoevgradit**, me logon "Prodhimi Lokal i Blagoevgradit". Ajo u shumëzua në një seri materialesh promovuese, duke përfshirë këtu etiketat speciale për kioskat e tregut, postera dhe shenja, bluza dhe kapele për shitësit. Dita e 6 tetorit 2018, u quajt një Ditë Tregu e veçantë, nën moton "Provoni Shijet Vjeshtore të Blagoevgradit" dhe u përdor për të testuar linjën lokale në tregun e hapur të qytetit.

Më 8 tetor 2018, **të moshuarit dhe fëmijët me nevoja të veçanta vendosën së bashku themelet e kopshtit periurban pilot në Dabravë,**

mbjelljen e pemëve të para të bajames në një komplot komunal dhe më pas bimët dhe perimet në pjesët e ngritura të kopshtit në pronën private aty pranë. Çdo fëmiju iu dha mundësia që 'të adoptojë' pemën e vet, të emërtuar sipas emrit të tyre. Shoqata e Pensionistëve gjithashtu mori edhe pemën e tyre personale dhe një copë të kopshtit. Iniciativa përfundoi me një piknik në kopsht për të dy grupet.

Të dy ngjarjet u promovuan kryesisht me ndihmën e radios lokale dhe mediave të shkruara, plus faqeve të internetit dhe rrjeteve sociale. Shoqata e Komunave Jugperëndimore krijoi një video të shkurtër nga iniciativa lokale, që u ngarkua në You- Tube dhe u nda në profilet e projektit. **Iniciativa lokale është vlerësuar si një sukses i madh nga të gjitha palët e përfshira dhe hapat pasues janë ende në planifikim.**

Grupet e synuara në kopsht



Máté Szalók

Ky publikim është rezultat i një procesi mësimor më shumë se dy vjeçarë, gjatë të cilit njëmbëdhjetë partnerë nga tetë shtete punuan së bashku për të zhvilluar dhe testuar një metodologji të bujqësinë urbane pjesëmarrëse. Ata e bënë këtë për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave komplekse: Partneriteti u përpoq të zvogëlonte zbrastësinë në besim ndërmjet administratës publike dhe qytetarëve duke përfshirë metodat pjesëmarrëse në vendimmarrje, dhe duke vënë theksin e veçantë në grupet shoqërore që kërcënohen nga rreziku i përjashtimit. Për më tepër, bujqësia urbane është gjithashtu një mjet për të stimuluar një mjedis urban të qëndrueshëm, që është një çështje vendimtare në agjendat aktuale urbane. Në këtë publikim u përmbledhën mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të projektit për të ofruar udhëzime mbi zbatimin e praktikave pjesëmarrëse të bujqësisë urbane.

Puna kërkimore dhe zhvillimi i koncepteve në gjysmën e parë të projektit ofruan një bazë të shëndoshë për aksionet pilot që synonin zhvillimin e strategjive lokale për sfidat e përmendura urbane. Hulimtimit në terren i Raportit të Vlerësimit mbi efektivitetin e para-projektit të bujqësisë urbane urbane në zonat pilot, përcaktoi drejtimet më të rëndësishme strategjike të politikave urbane bujqësore:

Sigurimi i tokës dhe financimi i bujqësisë urbane: Investimet në bujqësinë urbane ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, megjithatë përfitimet ekonomike dhe sociale nuk duhet të anashkalojnë, veçanërisht në rastin e grupeve të rrezikuara. Për t'i shfrytëzuar këto përfitime të bujqësisë urbane, komunat duhet të sigurojnë tokë për bujqësinë urbane përmes politikave të përdorimit të tokës urbane dhe ta financojnë atë përmes investimeve të vogla, por të drejtpërdrejta.

Rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe informimit mbi bujqësinë urbane: Shfrytëzimi i mundësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të bujqësisë urbane është ende në fazën fillestare, në Rajonin e Danubit.

Prandaj, duhet të merren masa të buta nga akterë kryesorë për të përhapur njohuritë dhe për të rritur ndërgjegjësimin për bujqësinë urbane, në mënyrë që të lehtësohet kapitalizimi i potencialit të saj.

Kopshtet urbane dhe fermat si pikë takime të grupeve të synuara: Gjatë hulumtimit të efektshmërisë para-projektuese të bujqësisë urbane pjesëmarrëse janë zbuluar ndryshime midis grupeve të synuara mbi pjesëmarrjen e publikut, që ndikon në rritjen e boshëllekut ndërmjet administratës publike dhe qytetarëve. Meqenëse kopshtet dhe fermat urbane funksionojnë si pika takimi, ato ofrojnë mundësi për të organizuar aty ngjarje publike, të cilat do të lehtësonin përfshirjen e qytetarëve në debate publike.

Gjatë zbatimit të veprimeve pilot, partnerët fituan përvojë praktike në lidhje me bujqësinë pjesëmarrëse urbane, e cila plotëson gjetjet strategjike të hulumtimit në terren. Çështjet e mëposhtme u identifikuan nga partnerët si mësimet kryesor dhe faktorë kryesorë të suksesit:

Të mësuarit dhe zhvillimi i shkathtësive: për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, të mësuarit nga njëri-tjetri dhe për njëri-tjetrin ka rëndësi kyçe. Vendimmarrësit, përfaqësuesit e grupeve të rrezikuara dhe sferat shoqërore duhet të jenë të hapura për të mësuar rreth sfidave të njëri-tjetrit si dhe marrjen e tyre në konsideratë gjatë procesit. Për më tepër, të mësuarit rreth metodave të reja dhe inovative në planifikimin strategjik urban, u mundëson qeverive lokale të ofrojnë shërbime më të mira për banorët dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës.

Komunikimi: Komunikimi rezultoi të jetë një faktor kyç në një proces pjesëmarrës. Disa nga partnerët përmendën se një nga rezultatet më të mëdha të pilotit ishte që komuna ishte e angazhuar në një proces të tillë dhe se filloi komunikimin e vazhdueshëm me grupet e tjera të synuara. Komunikimi i vazhdueshëm është vendimtar për t'i mbajtur pjesëmarrësit të interesuar. Duhet të zgjidhet mënyra e duhur e komunikimit, në rastin e grupeve të rrezikuara dhe të margjinalizuara, takimet ballë-për-ballë dhe punëtoritë u treguan të jenë mjaft efektive.

Përveç kësaj, ekziston edhe nevoja për të ndryshuar qëndrimin dhe për të mësuar aftësi të reja. Anëtarët e grupeve të rrezikuara / të marginalizuara duhet të mësojnë se si të shprehen, ndërsa administratorët publikë dhe vendimmarrësit duhet të mësojnë si të dëgjojnë.

Mjedisi miqësor: Në rastin e grupeve të rrezikuara / të marginalizuara, krijimi i një mjedisi miqësor për punën e përbashkët ka rëndësi vendimtare. Organizimi i punëtorive në mjediset e tyre, krijimi i mjedisit miqësor dhe joformal mund t'i ndihmojë ata të jenë më të hapur dhe mund të rrisë nivelin e angazhimit të tyre.

Prezantimi i praktikave të mira: Bujqësia urbane, si një mjet për planifikimin me pjesëmarrje, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, është një qasje e re dhe komplekse. Për këtë arsye, prezantimi i praktikave që tashmë kanë rezultuar të suksesshme mund të ndihmojë grupet e synuara që ta kuptojnë më mirë temën. Megjithatë, mënyrat e paraqitjes së këtyre praktikave janë gjithashtu të rëndësishme; metoda të ndryshme duhet të përdoren për fëmijët, të moshuarit, invalidët etj.

Vizitat në vendet ekzistuese bujqësore urbane mund të jenë gjithashtu një mjet efektiv për të mbështetur kuptimin e konceptit.

Ruajtja e besimit: Partnerët e përdorën bujqësinë urbane për të zvogëluar boshëllekun midis vendimmarrësve dhe qytetarëve. Fitimi i besimit është i rëndësishëm, por ruajtja e tij është gjithashtu e rëndësishme. Për këtë, shpërndarja e rezultateve të punëtorive të mëparshme mund të jetë efektive. Përveç kësaj, është e rëndësishme t'u tregohet grupeve të synuara se është e mundur që idetë e tyre të kthehen në realitet. Koha është gjithashtu një faktor. Pas seancave të planifikimit përpikuni të tregoni rezultate të shpejta - madje edhe të vogla - që të provoni aftësinë tuaj për të kuptuar idetë e tyre.

Përfshirja në çdo fazë të procesit: Përfshini grupeve e synuara jo vetëm në planifikim, por në çdo fazë të projektit, sepse kjo mund të rrisë angazhimin personal të pjesëmarrësve. Ndërtimi i kopshtit së bashku mund të formojë komunitetin dhe është gjithashtu një ngjarje kur pjesëmarrësit takohen në rrethana joformale.



Format e pjesëmarrjes: Formimi i një organizate zyrtare nga përfituesit mund të lehtësojë bashkëpunimin më të mirë me qeverinë lokale dhe organizatat e tjera. Kërkesat ligjore duhet të merren në konsideratë kur krijohet një vend bujqësor urban; dhe kështu është më e lehtë për shërbimet publike që të bashkëpunojnë me një organizatë sesa me individë. Nga ana tjetër, përmes angazhimit qytetar, banorët (përfshirë këtu grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara) mund të mësojnë për pjesëmarrjen demokratike dhe për bashkëpunimin me të tjerët.

Kini parasysh se bujqësia pjesëmarrëse urbane është një proces i ndërlikuar: Planifikimi pjesëmarrës, përfshirja sociale, mjedisi i qëndrueshëm urban dhe bujqësia urbane janë tema komplekse, por për t'iu referuar atyre së bashku kërkon një nivel edhe më të lartë kompleksiteti. Për këtë shkak, zbatimi i bujqësisë urbane pjesëmarrëse nuk është një proces i thjeshtë dhe i drejtë nga ideja deri tek realizimi, por një proces gjatë të cilit mund të ndryshojnë shumë faktorë. Përfshirja e të gjithë akterëve dhe koordinimi mes tyre nuk është i lehtë, por rezultatet do ta shpërblejnë. Vendosja e rregullave të qarta në fillim mund të lehtësojë bashkëpunimin.

Nga kuadri konceptual dhe nga veprimet pilot ne mund të shohim se bujqësia urbane pjesëmarrëse mund të përdoret në mënyra të ndryshme për të rritur përfshirjen sociale të grupeve të rrezikuara / të marginalizuara dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Përveç kopshteve komunitare, që kanë pasur më shumë vëmendje dhe shikueshmëri në vitet e mëparshme, ekzistojnë disa forma të tjera të kopshteve: siç janë kopshtet terapeutike, arsimore dhe sociale të cilat janë efektive për të adresuar nevojat dhe sfidat e përmendura. Për të krijuar një praktikë të suksesshme të bujqësisë urbane, forma më e përshtatshme duhet të zgjidhet me përfshirjen e aktorëve dhe përfituesve.

Aksionët pilot të AgriGo4Cities si dhe vetë projekti mund të konsiderohen të suksesshëm, por pjesa më e vështirë do të vijë pas përfundimit të projektit. Partneriteti ka ndërmarrë përpjekje serioze për të siguruar qëndrueshmërinë e vendeve bujqësore urbane të krijuara, për zgjerimin e pilot-ëve dhe për të bërë ndryshime sistematike. Por pas përfundimit të projektit, qeveritë lokale dhe shoqatat e tjera pjesëmarrëse do të jenë përgjegjës për menaxhimin e vendeve bujqësore urbane dhe për të përdorur rezultatet e pilot-ëve, duke integruar mësimet e fituara në politikat e tyre lokale.

Partneriteti i AgriGo4Cities mendon që rajoni i Danubit të jetë një rajon i shëndetshëm, ka nevojë për qytete të gjelbëra dhe gjithëpërfshirëse. Me anë të projektit ne u përpoqëm t'u përgjigjemi disa prej nevojave dhe sfidave të fundit të qyteteve të Rajonit të Danubit duke aplikuar një metodë inovative: Bujqësinë Urbane Pjesëmarrëse. Duke u bazuar në përvojat tona, ne e konsiderojmë bujqësinë urbane pjesëmarrëse si një nga mjetet e ndryshme që mund të na ndihmojnë t'i bëjmë qytetet tona më gjithëpërfshirëse dhe të rrisim cilësinë e jetës së qytetarëve të tyre.



Cunk K, Straus M, Zamfira R (eds); Pranimi i Bujqësisë Urbane si një Inovacion Social: Udhëzime për Zhvillimin dhe Zbatimin e një plan veprimi.(2017) Koper: Shoqata për Kulturë dhe Arsim, PiNA, qasje në: http://www.interreg-danube.eu/uploads/media/approved_project_output/0001/22/b5c8a9e91e67f33f-da8dd6ce9c9a11bbaa31c18e.pdf

Cunk K, Weixler E (eds), Përgatitja për Plan Veprim, Një llogari e seancës trajnuese (2017). Koper: Shoqata për Kulturë dhe Arsim, PiNA, qasje në: http://www.interreg-danube.eu/uploads/media/approved_project_output/0001/14/daac744044601604f458b2e1694c405b8be8566b.pdf

Kozina J, Tiran J: Raport Vlerësimi mbi efektivitetin para-projektit të bujqësisë urbane pjesëmarrëse në zonat pilot (2018). Lubjanë: ZRC SAZU (exante), qasje në: http://www.interreg-danube.eu/uploads/media/approved_project_output/0001/22/88d135a1306720c22cc531c947b3409510b53a36.pdf

Kozina J, Tiran J, Poljak Istenič S, Repolusk P, Ercegović J, Krušec K, Kladnik D, Šmid Hribar M, Ferk M, Kumer P, Rus P: Raport Inventari mbi gjendjen e artit bujqësor pjesëmarrës në rajonin pilot të Danubit (2017). Lubjanë: ZRC SAZU, qasje në: http://www.interreg-danube.eu/uploads/media/approved_project_output/0001/14/7c02b7b244ac5956113ccc70837aeb951a5e2a45.pdf

Lohrberg, F., Lička, L., Scazzosi, L, Timpe, A; Bujqësia Urbane në Evropë (2016). Berlin: jovis Verlag GmbH.

Šmid Hribar M, Poljak Istenič S, Kozina J, Kumer P (eds); Katalogu i Praktikave të Mira për bujqësinë urbane pjesëmarrëse (2018). Ljubljana: ZRC SAZU, Založba ZRC, qasje në: http://www.interreg-danube.eu/uploads/media/approved_project_output/0001/22/b5c8a9e91e67f33fda8dd6ce9c9a11bbaa31c18e.pdf

PARTNERITETI

Qendra Kërkimore e Akademise dhe Arteve te Sllovenise (ZRC SAZU)

🏠 Novi trg 2, SI-1000 Ljubjanë, Slloveni

🌐 <https://giam.zrc-sazu.si/en>

👤 **Personi kontaktues:**

Jani Kozina, jani.kozina@zrc-sazu.si



Qendra Kërkimore e Akademise dhe Arteve te Sllovenise është qendra kryesore kërkimore sllovene për shkencat humane dhe një institucion i avancuar akademik në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Ka një karakter multidisiplinar dhe ndërdisiplinor; përveç shkencave humane, sferat e saj të hulumtimit gjithashtu mbulojnë shkencat natyrore dhe shoqërore. Qendra Kërkimore e Akademise dhe Arteve te Sllovenise ka shtëpinë e vet botuese, librari dhe disa laboratorë; ajo përfshinë Muzeun Gjeografik, dhe posedon koleksione të shumta. Ndërmjet veprimtarisë së pasur botuese, pesë revista akademike janë të listuara nga Thomson Reuters. Ajo përfshin 18 institute kërkimore.

Qarku Komunal Pragë 9 (Pragë 9)

🏠 Sokolovská 324/14, 180 49 Pragë, Republika Çeke

🌐 <https://www.praha9.cz/>

👤 **Personat kontaktues:**

Zdeněk Davídek, davidekz@praha9.cz;

Pavel Pospíšek, pospisekp@praha9.cz



Qarku Komunal i Pragës 9 ndodhet brenda kryeqytetit të Republikës Çeke. Është një nga rrethet administrative të Pragës dhe ndodhet në pjesën veri-lindore të të gjithë kryeqytetit. Për shkak të vendndodhjes së saj - as në qendër të qytetit, as në periferi - Pragë 9 është një zonë ish industriale e cila po zhvillohet me shpejtësi në një zonë banimi. Në zonën e Pragës 9 ju mund të gjeni edhe vende që janë përdorur nga fabrika/kompani dhe parqe të revitalizuara, terren kodrinor dhe është pranë një prurje të vogël, por të rëndësishme në lumin Moldau, një qark me prona dhe strehim familjar. Pragë 9 është gjithashtu shtëpia e arenës më të famshme në botë, Arenës O2.

Agjencia për Zhvillim Evropian(EUDA)

🏠 Na Čihadle 55, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke

🌐 <http://euda.eu/>

👤 Personat kontaktues:

Martin Rejmíš, martin.rejmis@eracr.cz;
Kateřina Janatová; katerina.janatova@eracr.cz



european development agency

Agjencia për Zhvillim Evropian është një kompani private që vepron si drejtuese e një rrjeti të gjerë të BE-së të institucioneve dhe ekspertëve në fushën e arsimit, inovacionit dhe zhvillimit rajonal të BE-së. Që nga viti 2008, Agjencia për Zhvillim Evropian ka krijuar një rrjet të gjërë të partnerëve me një sërë institucioneve dhe ndërmarrjesh nga e gjithë BE-ja, zona ekonomike evropiane (ZEE) dhe vendet e tjera. Rrjeti përshkon të gjithë sektorët dhe përfshin subjektet publike, si dhe ato private. Agjencia synon të furnizojë rrjetin e vet me njohuri, programet ndërkombëtare të arsimit, mbështetjen e partnerëve të kërkimit, zhvillimin e projekteve dhe shërbimet e administrimit. Ajo ka krijuar shumë partneritete të forta në kuadrin e projekteve evropiane. Agjencia ka marrë pjesë gjithashtu në projektet e bashkëpunimit ndërkombëtar duke përfshirë programe të tilla si Interreg Europa Qëndrore / Danubi, Erasmus+, etj.

Komuna Velenje (MOV)

🏠 Titov trg 1, 3320 Velenje, Sloveni

🌐 www.velenje.si

👤 Personat kontaktues:

Nela Halilović, Mojca Kodrič;
Agrigo4cities@velenje.si



MESTNA OBČINA
VELENJE

Qyteti Velenje ndodhet në pjesën verilindore të Sllovenisë, midis kodrave të gjelbëruara të Luginës Šalek. Qyteti më i ri në vend, u zhvillua nga minierat e qymyrgurit dhe industria në 60 vitet e fundit. Me një proces zhvillimi të pazakontë në vitet e para të historisë së saj, u ndërtua për minatorët që kalonin shumë kohë në tokë, me synim krijimin e një vendi të gjelbërt, me diell, dhe të shëndetshëm për të jetuar me familjet e tyre. Inovacioni mbeti një tipar i përbashkët deri më sot, pasi që u bë një praktikë e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm, menaxhimin e mjedisit dhe kusht mbështetës për zhvillimin e biznesit. Komuna Velenje kryen detyrat e imponuara në legjislacionin e vetëqeverisjes.

Agjencia Qëndrore Transdanubiane e Inovacionit Rajonal (CTRIA)

🏠 8000 Székesfehérvár, Seregélyesi út 113, Hungari

🌐 www.kdriu.hu

👤 **Personat kontaktues:**

Ákos Szépvölgyi, szepvol@kdriu.hu;

Máté Szalók, mate.szalok@kdriu.hu



Central Transdanubian Regional Innovation Agency

Agjencia Qëndrore Transdanubiane e Inovacionit Rajonal filloi punën në vitin 2005 si një union dhe në vitin 2008, nga gjashtë organizata, u themelua Agjencia jo fitimprurese Qëndrore Transdanubiane e Inovacionit. Kjo agjenci punon për koordinimin e proceseve rajonale të inovacionit në Transanubinë Qendrore, organizimin e rrjeteve teknologjike të inovacionit dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes së inovacionit. Agjencia bashkëpunon me zhvilluesit e projekteve ndërkombëtare, sipërmarrësit potencialë, persona që ofrojnë ide, ndërmarrjet inovative, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, administratorët publikë, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore dhe qeveritë lokale.

Komuna Vaslui (PMV)

🏠 Rruga Haret Spiru, nr. 2, Vaslui, Rumani

🌐 www.primariavaslui.ro

👤 **Personat kontaktues:**

Stefan Dudau, stefanddudau@gmail.com;

Irina Ciurea Popovici, programeprimvs@yahoo.com



Komuna Vaslui (Rumani) është qendra më e rëndësishme urbane në qarkun Vaslui (me mbi 130.000 banorë sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të realizuar në janar 2019) dhe aktualisht përmbush rolin e saj rezidencial. Së bashku me lokalitetet e tjera që përbëjnë zonën metropolitane, ky grumbullim urban është njëkohësisht qendra kryesore polarizuese, në nivel qarku, ndër funksionet e shumta që kryen mund të përmendim ato administrative, ekonomike, sociale, kulturore, mjekësore, arsimore.

ENVICORP Sllovakia (ENVICORP)

🏠 Horná 89/3915, 974 01 Banská Bystrica, Sllovakia

🌐 <https://envicorp.webnode.sk/o-nas/>

👤 **Personat kontaktues:**

Martin Lakanda, envicorp@gmail.com;

Lucia Vačoková, lucia.vacokova@gmail.com



ENVICORP Sllovakia është një OJQ profesionale që punon me një grup profesionistësh të kualifikuar në mjedis dhe ekologji. Anëtarët e OJQ-së kanë ekspertizë edhe në planifikimin pjesëmarrës dhe strategjik: një element që do të jetë vendimtar për projektin e AgriGo4Cities. Anëtarët e ENVICORP Sllovakia janë autorë dhe bashkëautorë të disa metodologjive në temat e: edukimit mjedisor, zhvillimit të qëndrueshëm të zonave evropiane malore, sistemeve hapësinore të stabilitetit ekologjik e kështu me radhë. Në mes tyre, tema e bujqësisë urbane dhe periurbane zë njërin nga pozicionet më qendrore. ENVICORP Sllovakia është një OJQ që zbaton aktivitete në nivel kombëtar dhe transnacional.

Shoqata për Kulturë dhe Arsim, PiNA (PiNA)

🏠 15 Gortanov trg, 6000 Koper, Slloveni

🌐 www.pina.si

👤 **Personi kontaktues:**

Kaja Cunk, kaja.cunk@pina.si



Shoqata PINA, e themeluar në vitin 1998, është një organizatë joqeveritare që lidh njerëzit, organizatat e shoqërisë civile, strukturat publike dhe përfaqësuesit politikë nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe informative. Ajo është një qendër informacioni e drejtpërdrejtë e Evropës, një partner rajonal i Eurodesk-ut, një qendër për të rinj me statusin e veprimit në interes të publikut në fushën e të rinjve dhe HUB-it të OJQ-ve rajonale. Shoqata PiNA ka përvojë në koordinimin e projekteve ndërkombëtare (In- terreg, Erasmus +, Europa për Qytetarët, Fondi Social Evropian, Mekanizmi Financiar i Norvegjisë), mbulim të gjerë tematik (punësimi i të rinjve, sipërmarrje shoqërore përgjegjëse, të menduarit krijues dhe planifikimin e veprimeve), dhe ka 10 të punësuar me kohë të plotë, dhe më shumë se 40 ekspertë të jashtëm.

Shoqata e Komunave Jugperëndimore (ASWM)

🏠 Rruga 23 Todor Aleksandrov, kati i 3, zyra nr. 32, Blagoevgrad 2700, Bullgari

🌐 www.aswm.net

👤 **Personat kontaktues:**
Lyubitsa Tomova, Nadezhda Blagova;
aswm@abv.bg, office@aswm.net



Shoqata e Komunave Jugperëndimore është themeluar në vitin 2000 si një entitet ligjor jofitimprurës që punon për mirëqenien publike. Objektivat e Shoqatës janë të mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e përbashkëta të komunave/bashkive anëtare; të koordinojnë veprimet e anëtarëve për të zgjidhur problemet lokale dhe për të zhvilluar vetëqeverisjen lokale; për të ofruar shërbime cilësore dhe të larmishme për anëtarët dhe për të inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë në qeverisjen lokale. Ndihmë dhe këshillim nga ekspertë për: zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve; zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe transparente; përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara; zhvillimin e ngjarjeve publike; planifikimin dhe programimin e zhvillimit lokal dhe rajonal.

Njëzet e gjashtë komuna nga Bullgaria Jugperëndimore janë anëtarë të kësaj shoqate.

ifuplan – Instituti për Planifikim Mjedisor dhe Zhvillim Hapësinor

🏠 Rruga Amalien 79, 80799 Mynhen, Gjermani

🌐 www.ifuplan.de

👤 **Personat kontaktues**
Stefan Marzelli, stefan.marzelli@ifuplan.de;
Florian Lintzmeyer, florian.lintzmeyer@ifuplan.de

The logo for ifuplan features the word 'ifuplan' in a bold, lowercase, sans-serif font. The letter 'i' is stylized with a green dot above it.

Gjatë 25 viteve të fundit, ky institut ka ofruar shërbime të shumta në lidhje me planifikimin mjedisor dhe zhvillimin hapësinor. Risia në punën tonë lind - përveç interesit tonë themelor në gjëra të reja - nga puna jonë në bashkëveprimin e shkencës dhe praktikës. Ne jemi të bindur që planifikimin mjedisor dhe zhvillimin hapësinor janë fusha të punës kuptimplota dhe të orientuara drejt së ardhmes. Projektet tona të shumta shkojnë nga niveli ndërkombëtar në nivel lokal dhe kombinojnë çështje strategjike me zbatime konkrete lokale - një shumëllojshmëri që na magjeps çdo herë.

Komuna e Ulqinit

🏠 Bul. Skenderbeu pn, 85360 Ulqin, Mali i Zi

🌐 www.ul-gov.me

👤 **Personi kontaktues:**

Artan Çoboviq, artan.cobaj@ul-gov



Ulqini është një qytet bregdetar në Mal të Zi dhe ka një popullsi prej 20.000 banorësh. Qyteti kufizohet nga Deti Mesdhe dhe si rrjedhojë është një destinacion i njohur turistik. Për shkak të klimës mesdhetare, Ulqini ka gjithashtu një sektor të zhvilluar bujqësor. Komuna synon të krijojë modele të reja të qeverisjes për të filluar një dialog mes qytetarëve dhe shërbimeve publike, që është edhe arsyeja kryesore për të cilën iu bashkua partneritetit të AgriGo4Cities.

Bashkëpunëtorët strategjikë

- Agjencia Rajonale e Zhvillimit të Rajonit Urban të Lubjanës (Slloveni)
- Bashkia e Pragës (Republika Çeke)
- Shoqata e Komunave të Sllovenisë, Zyra Rajonale Koper (Slloveni)
- EBB Europaberatung (Gjermani)
- Shërbimi i Punësimit të Sllovenisë, Zyra Rajonale Koper (Slloveni)
- Shoqata Euni (Bullgari)

SHËNIME







Agjencia Qëndrore Rajonale Transdanubiane e Inovacionit

A projekt a Duna Transnacionális Programból, az Európai Regionális Fejlesztési Alap támogatásával, az Európai Unió és a Magyar Állam társfinanszírozásával valósul meg.

Projekti bashkëfinancohet nga fondet e Bashkimit Evropian (ERDF, IPA, ENI)

0 facebook .com /AgriGo4Cities **0** @AgriGo4Cities

(1) www.interreg-danube.eu/agrigo4cities